



**STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

**DREJTIMI - DIPLOMACI**

**TEZA E MAGJISTRATURËS**

**“Roli i EULEX-it në përkrahjen e institucioneve vendore të Kosovës”**

**KANDIDAT**

**Naim Maliqi**

**MENTOR**

**Prof.dr. Abdulla Azizi**

**Tetovë, Shtator 2017**

## **D E K L A R A T Ë**

Unë Naim Maliqi, student i Universitetit të Evropës Juglindore – Tetovë në studime pasdiplomike pranë Fakultetit të Administrimit Publik dhe Shkencave Politike drejtimi Diplomaci, deklaroj se ky punim i magistraturës është rezultat i punës sime kërkimore e shkencore.

Publikimeve të shfrytëzuara u jam referuar duke i cituar në fusnota, përfshirë këtu edhe burimet nga interneti.

Deklaroj se tema është lekturuar nga: Prof. Valbona Ramadani

Kandidat:

Naim Maliqi

# PËRMBAJTJA

|                                                                                                                                        |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| PËRMBAJTJA.....                                                                                                                        | 3  |
| Abstrakti.....                                                                                                                         | 4  |
| Abstract.....                                                                                                                          | 5  |
| HYRJE.....                                                                                                                             | 6  |
| KAPITULLI I .....                                                                                                                      | 8  |
| NJË HISTORIK I SHKURTËR I BASHKËPUNIMIT BASHKIMI EVROPIAN – KOSOVË .....                                                               | 8  |
| 1. 1. Përpyqjet e Bashkimit Evropian gjatë krizës në Kosovë .....                                                                      | 8  |
| 1. 2. Aktivitetet e Bashkimit Evropian në vendosjen e paqes në Kosovë .....                                                            | 9  |
| 1. 3. Proceset që i paraprinë vendosjes së EULEX-it në Kosovë .....                                                                    | 14 |
| MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË .....                                                                                           | 17 |
| 2. 1. Plani gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës i Presidentit Ahtisaari.....                                                       | 17 |
| 2. 2. Baza ligjore e Misionit.....                                                                                                     | 19 |
| 2. 3. Mandati dhe kompetencat .....                                                                                                    | 23 |
| 2.4. Roli i komponentes së policisë, doganave dhe drejtësisë në përkrahjen e mbajtjes së rendit dhe sundimit të ligjit në Kosovë ..... | 29 |
| KAPITULLI III .....                                                                                                                    | 37 |
| NDIKIMI I MISIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN DHE MBËSHTETJA E KOSOVËS NË PROCESET EURO-INTEGRUESE .....                                    | 37 |
| 3. 1. Pozita e shteteve të Ballkanit përëndimor në proceset integruese .....                                                           | 37 |
| 3. 2. Përfshirja e Kosovës në politikat integruese të BE-së .....                                                                      | 40 |
| 3. 3. Raportet e progresit për Kosovën.....                                                                                            | 42 |
| 3. 4. Marrëveshja për procesin e stabilizim asociimit.....                                                                             | 46 |
| PËRFUNDIM .....                                                                                                                        | 53 |
| CONCLUSION.....                                                                                                                        | 56 |
| BIBLOGRAFIA.....                                                                                                                       | 59 |

## Abstrakti

EULEX-i është misioni më i madh civil i ndërmarrë ndonjëherë nga Politika e Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje e BE-së (PBSM). Synimi kryesor është ofrimi i ndihmës dhe i mbështetjes në fushën e sundimit të ligjit për autoritetet e Kosovës, në mënyrë të veçantë sektorit të policisë, të gjyqësorit dhe të doganës. Ky mision nuk ka për qëllim të qeverisë me Kosovën apo ta sundojë atë. Është një mision teknik i cili monitoron, udhëzon dhe këshillon, duke mbajtur disa kompetenca të kufizuara ekzekutive.

EULEX-i është themeluar në rrethana unike dhe komplekse politike, të cilat kanë pasur implikime juridike vendore dhe ndërkombëtare për funksionimin e misionit. EULEX-i është dashur që vendosjen e vet ta bëjë të pranueshme për të dyja, Kosovën dhe Serbinë. Nga këndvështrimi i Kosovës, prania e EULEX-it është arsyetuar ligjërisht dhe praktikisht duke iu referuar Deklaratës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, planit të Ahtisaari si dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të tria këto të refuzuara dhe të papranueshme për Serbinë. Ndërsa nga këndvështrimi i Serbisë, prania e EULEX-it është arsyetuar në bazë të pranimit të këtij të fundit për të vepruar në bazë të mandatit "neutral ndaj statusit" dhe për të marrë pjesë në zbatimin e Planit Gjashtë Pikësh të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (SPKB), të dyja këto të refuzuara dhe të papranueshme për Kosovën.

Misioni EULEX-it ka filluar punën me kapacitete operative fillestare në dhjetor të vitit 2008 ndërsa në prill të vitit 2009 me kapacitet të plotë operacional.

Qëllimi i kësaj teme është që të paraqesë analizën e punës së Misionit të Bashkimit Evropian në përkrahjen e institucioneve vendore, të arriturat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohet ky mision.

Përveç kësaj, qëllim tjetër është edhe zbulimi i mangësive në drejtim të ushtrimit të mandatit të misionit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, por edhe dhënia e sugjerimeve për përmirësimin e situatës aktuale në fushat ku ka ngecje, e që shumica prej tyre lidhen ngushtë me kriteret për proceset integruese në BE.

Për realizimin e kësaj teme janë përdorur një sërë metodash, si: metoda analitike, e intervistimit, krahasuese dhe deskriptive/historike.

## **Abstract**

EULEX is the largest civilian mission ever launched under the Common Security and Defense Policy (CSDP). The central aim is to assist and support the Kosovo authorities in the rule of law area, specifically in the police, judiciary and customs area. The mission is not in Kosovo to govern or rule. It is a technical mission which will monitor, mentor and advise whilst retaining certain executive power.

EULEX was established under unique and complex political circumstances, which had domestic and international legal implications for the functioning of the mission. EULEX had to make its deployment acceptable to both Kosovo and Serbia. From the perspective of Kosovo, the presence of EULEX was justified legally and practically with reference to the Declaration of Independence of the Republic of Kosovo, the Ahtisaari Plan and the Constitution of the Republic of Kosovo, all three rejected and unacceptable to Serbia. While from Serbia's point of view, EULEX's presence was justified on the basis of the latter's acceptance to act on the status neutral mandate and to participate in the implementation of the Six Point Plan of United Nations Secretary-General (UNSG), both rejected and unacceptable for Kosovo.

The EULEX mission reached its full initial capacity in December 2008 and its full operational capability in April 2009. The aim of this topic is to present the analysis of the work of the European Union Mission in supporting local institutions, achievements and difficulties faced by this mission.

In addition, another purpose is to detect shortcomings in the exercise of its mandate throughout the territory of the Republic of Kosovo, but also to provide suggestions for improving the current situation in areas where there is stagnation, and most of them are closely related to criteria for EU integration processes.

For the realization of this topic, a series of methods were used as analytical, interviewing, comparative and descriptive / historical.

## HYRJE

Kosova, gjithmonë gjatë historisë së saj ekzistencën e vetë e ka mbështetur tek përkrahja e botës perëndimore. Në të njëjtën kohë ka synuar që një ditë të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, madje edhe në momentet më të vështira të saj asnjëherë nuk iu shua dëshira që një ditë të bëhet anëtare e familjes së madhe evropiane. Kjo aspiratë vetëm sa u rritë me prezencën e Bashkimit Evropian dhe sidomos me shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 Shkurt të vitit 2008. Një rol të rëndësishëm në konsolidimin dhe në përkrahjen e njërës prej shtyllave kryesore të shtetit, që është ai i sundimit të rendit dhe ligjit e ka pasur dhe vazhdon ta ketë Misioni i Bashkimi Evropian në Kosovë- EULEX.

Duke qenë vetë pjesë e misionit të EULEX-it qysh prej fillimit të mandatit në Kosovë si dhe rëndësinë që ka prezenca e tij, më ka shtyrë që të bëjë këtë hulumtim. Ndër vite në Kosovë ka pasur një mosbesim në institucionet vendore të drejtësisë që është si rezultat i së kaluarës kur është abuzuar me të nga ish regjimi, por edhe si rezultat i përceptimi se kishte ndërhyrje të politikës në vendimet gjyqësore. Pra, EULEX-i ka filluar punën në rrethana të tilla ku ekzistonte një mosbesimi i thellë ndaj institucioneve vendore, duke ia kthyer shpresën popullatës për një sistem më të mirë të drejtësisë. Pasi unë punoja në zyrën e prokurorit të EULEX-it në rajonin e Gjilanit, dhe isha përgjegjës për pranimin e ankesave, mua personalisht më është dashur t'iu refuzoj ankesat shumicës së tyre pasi ishte e pamundur të trajtoheshin të gjitha ato, por edhe sepse EULEX-i nuk ishte këtu si zëvendësues i institucioneve vendore por vetëm si ndihmës me disa fuqi ekzekutive për disa lëndë që ishin të natyrës më serioze por edhe atyre ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të niveleve të ndryshme.

Në këtë punim kam bërë një analizë të punës së Misionit të Bashkimit Evropian në përkrahjen e institucioneve vendore në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës, bazës ligjore, kompetencave dhe mandatit, të arriturave dhe vështirësive me të cilat ballafaqohet ky mision në drejtim të ushtrimit të mandatit të tij në tërë Kosovën. Gjithashtu, jam munduar të paraqesë ecurinë e misionit që nga fillimi deri në ristrukturimin e fundit që ka ndodhur në nëntor të vitit 2016, ku shumica e përgjegjësive janë bartur tek institucionet vendore duke u fokusuar më tepër në monitorim, mentorim dhe këshillim.

Fillimisht në kapitullin e parë kam bërë një retrospektivë të rrugëtimit të Kosovës drejt forcimit të subjektivitetit të saj si dhe marrëdhëniet në raport me Bashkimin Evropian. Pastaj, aktivitetet që Bashkimi Evropian ka ndërmarrë në vendosjen e paqes në Kosovë, ku Kosova sapo kishte dalë nga një luftë shkatërrimtare dhe kishte nevojë për një ndihmë të gjithëmbarshme. Në vazhdim të këtij kapitulli është analizuar e gjithë historia e proceseve që i paraprinë vendosjes së Misionit të Bashkimit Evropian, vështirësive që ishin hasur gjerë në vendosjen përfundimtare dhe fillimit të punës.

Në kapitullin e dytë jam ndalur tek fillimet e bisedimeve për statusin e Kosovës, përkatësisht planit të ish Presidentit Finlandez Martti Ahtisaari, që ishte i emëruar si përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurimit për çështjen e statusit, që njëherit edhe hapi rrugën për praninë e misionit të Bashkimit Evropian në fushën e rendit dhe sundimit të ligjit. Duke analizuar po ashtu bazën ligjore, kompetencat dhe mandatin e misionit, si dhe punën e komponentëve veç e veç.

Duke e parë rëndësinë e procesit të integriteteve evropiane për Kosovën, dhe ndikimin e këtij misioni, në këtë punim jam përpjekur të pasqyroj dhe analizoj duke krahasuar politikat e Bashkimit Evropian karshi Kosovës që përbente një rast të veçantë, dhe kishte një trajtim tjetër nga shtetet e tjera të rajonit në rrugëtimin e saj drejt proceseve euro-integruese pasi nuk njihet nga pesë shtetet e Bashkimit Evropian. Kjo ka paraqitur shpesh here edhe pengesë në ushtrimin e mandatit të misionit.

Misioni i Bashkimi Evropian EULEX është duke i përkrahur institucionet e Kosovës në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit. Ky mision ka rëndësi po ashtu për ndihmën që po i jep institucioneve vendore në plotësimin e njërit prej kritereve kryesore atë të sundimit të rendit dhe ligjit që është parakusht për proceset euro-integruese të Kosovës.

Siç u përmend edhe më lartë për realizimin e kësaj teme janë përdorur një sërë metodash si metoda analitike, e intervistimit, krahasuese dhe deskriptive/historike.

## KAPITULLI I

### NJË HISTORIK I SHKURTËR I BASHKËPUNIMIT BASHKIMI EVROPIAN – KOSOVË

#### 1. 1. Përpyjekjet e Bashkimit Evropian gjatë krizës në Kosovë

Populli i Kosovës pas luftës së dytë botërore shpresonte se edhe ai do të gëzonte të drejtat dhe lirinë si të gjithë popujt tjerë, por kjo nuk ndodhi pasi vetëm u ndërruan pushtuesit. Me këtë filloi një fazë edhe më e egër e persekutimit të popullit shumicë të Kosovës. Në vitet e 60-ta fillojnë përpyjekjet e popullit shqiptarë të Kosovës për subjektivizëm të Kosovës brenda strukturave jugosllave. Përpyekja e vazhdueshme e subjektivizmit kosovar dhe pakënaqësitë e pozitës së popullit shqiptar brenda Kosovës karakterizohet me ngritjen e pozitës kushtetuese të Kosovës nën ish RSFJ-në në vitin 1974, ndërsa e njëjta pozitë kushtetuese u suprimua me shfaqjen e nacionalizmit serb brenda ish-RSFJ-së në vitin 1989, e cila ndikoi edhe në shkatërrimin gradual të ish RSFJ-së dhe shkaktoi luftëra mes gjithë popujve të ish RSFJ-së në vitet e 90-ta.<sup>1</sup> Gjatë gjithë kësaj kohe nuk kemi ndonjë rol të rëndësishëm të Bashkimit Evropian në raport me Kosovën, përveç disa vizitave të disa zyrtareve që bënë monitorimin e situatës në Kosovë dhe disa raporteve periodike mbi gjendjen e përgjithshme të drejtave të njeriut në Kosovë. Kosova lëvizë nga rruga e politikës paqësore të kundërvënies drejt formimit të strukturave ushtarake për rezistencë, përballë represionit të vazhdueshëm të regjimit serb në Kosovë, i cili intensifikoi masat e represionit shtetëror ndaj popullatës shumicë të Kosovës. Në vitin 1998 me eskalimin e situatës në terren kemi një lëvizje më të theksuar të Diplomacisë Evropiane të përfaqësuar në kuadër të grupit të kontaktit ku bënë pjesë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Rusia dhe Italia. Duke folur para grupit të

---

<sup>1</sup> Christopher Bennett, *Yugoslavia's Bloody Collaps*, London, 1995, p. 83-106.



kontaktit, ish sekretarja e shtetit Madeline Albright, në Mars të vitit 1998 fajësoi për dhunë Millosheviqin. Ajo theksoi kushtet të cilat Millosheviqi dhe qeveria e tij duhet t'i pranojnë duke përfshirë edhe prezencën e monitoruesve ndërkombëtare në Kosovë. Kishte edhe një përpjekje ndërkombëtare që të evitohej lufta në Kosovë, Konferenca e Rambujesë por e cila nuk rezultoi me nënshkrimin e një marrëveshje nga te dy palët. Përderisa pala kosovare e nënshkroi atë, pala serbe refuzoi ta nënshkruajë. Pasi nuk kishte mbetur rrugëdalje tjetër, Aleanca Veriatlantike-NATO filloi bombardimin e caqeve te forcave serbe në Kosovë dhe në republikën e atëhershme federative te Jugosllavisë të përberë nga Serbia dhe Mali i Zi, për të parandaluar gjenocidin ndaj popullatës së pambrojtur dhe shpërnguljes se mbi 1 milion shqiptarëve jashtë Kosovës, e cila së bashku me përvojën e hidhur në Bosnjë dhe Hercegovinë ndikuan në ndërhyrjen humanitare të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë nën udhëheqjen e Organizatës së Traktatit Veriatlantik(NATO).

Ky intervenim ushtarak i bashkësisë ndërkombëtare i dha fund destabilizimit të Ballkanit dhe filloi epoka e re e frymës demokratike dhe hapja e perspektivës Evropiane për tërë rajonin duke përfshirë edhe Kosovën.

## **1. 2. Aktivitetet e Bashkimit Evropian në vendosjen e paqes në Kosovë**

Që nga viti 1999, Bashkimi Evropian (BE) ka luajtur një rol udhëheqës në përpjekjet ndërkombëtare për ndërtimin e një ardhmërie të re për Kosovën. Kosova ka një perspektivë të qartë në Evropë, si pjesë e rajonit më të gjerë të Ballkanit Perëndimor. Angazhimi i BE-së fillon me dhënien e ndihmës humanitare dhe rindërtimin ekonomik dhe më pastaj vazhdon me përkrahjen politike fillimisht me përkrahjen në bërjen e shtetit të Kosovës e më pastaj në konsolidimin e shtetit dhe në ofrimin e perspektivës evropiane.

Faza e parë e ndihmës direkte te BE-së për Kosovën fillon pas vitit 1999, duke i ndihmuar Kosovës me asistence humanitare, për te tejkaluar pasojat qe kishte pësuar nga lufta, ndërsa në një fazë të mëvonshme si pjesë e Misionit të Kombeve te Bashkuara në Kosovë

(UNMIK), përmes shtyllës së katërt të saj<sup>2</sup>, ajo mori përgjegjësinë e rindërtimit dhe zhvillimit ekonomik. Gjatë kësaj periudhe, BE kishte përdorur për herë të parë në Kosovë dhe rajon instrumentin e ndihmës financiare nën menaxhim të Agjencisë Evropiane për Rindërtim,<sup>3</sup> e cila mbështeti projekte të ndryshme në ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin në infrastrukturë. Ndërsa me ndërtimin gradual të institucioneve vendore, BE, fillimisht përfshinë Kosovën në tryezat rajonale të Paktit të Stabilitetit ndërsa më vonë nën udhëheqjen e shtyllës së katërt, BE i kishte ofruar institucioneve të Kosovës mundësinë e marrëveshjeve bilaterale tregtare me shtetet fqinje. Kjo kishte për qëllim fillimin e krijimit të një zone të lirë tregtare me vendet fqinje në mënyrë që Kosova të mos mbes mbrapa në procesin e integrimi ekonomike në rajon. Marrëveshjet bilaterale tregtare të Kosovës me shtetet fqinje si dhe zgjerimi dhe hapja graduale e tregut të Kosovës kanë ofruar një mundësi reale për liberalizimin e tregut kosovar në nivel rajonal. Më vonë kjo zonë e lirë tregtare e Ballkanit Perëndimor u kyç edhe në tregun më të madh të Evropës qendrore të ashtuquajturin CEFTA,<sup>4</sup> e cila është një parapërgatitje e zonës së Ballkanit Perëndimor për hyrjen e plotë në zonën e madhe të lirë tregtare të Bashkimit Evropian që ofron lëvizje të lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit.

Mbledhja e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB) e mbajtur më 10 Qershor 1999 përmes miratimit të rezolutës 1244<sup>5</sup> përcaktoi mandatin e prezencës ndërkombëtare në Kosovë, dhe autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm të themelojë një prezencë ndërkombëtare për të siguruar një administratë të përkohshme në Kosovë. Prezenca ndërkombëtare në Kosovë, që u njoh me emrin Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), sipas rezolutës 1244, kishte përgjegjësinë që në pritje të zgjidhjes së statusit final të Kosovës, të promovojë një autonomi substanciale dhe institucionet vetëqeverisëse në Kosovë duke marrë për bazë edhe marrëveshjet e aneksit 2 të konferencës së Rambujesë, ushtrimin e funksioneve themelore civile administrative, organizimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të

---

<sup>2</sup> Shtylla e Katërt nën ombrellën e MKBK-së, gjatë periudhës 1999 deri në pjesën e parë të vitit 2008, është udhëhequr nga Bashkimi Evropian, mandati i të cilës ka qenë në rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës

<sup>3</sup> Agjencioni Evropian i Rindërtimit(AER) si instrument i BE-së në rajon dhe Kosovë përfundon mandatin e tij në fund të vitit 2008. Zëvendësimi i tij bëhet nga shtrirja e delegacioneve të Komisionit Evropian në rajon.

<sup>4</sup> Shih Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore/Central Europe Free Trade Agreement (CEFTA).

<sup>5</sup> Resolution 1244, UN Security Council, 10th of June 1999. Burimi: <http://www.unmikonline.org/press/reports/N9917289.pdf>

përkohshme demokratike, transferimin e përgjegjësiave administrative duke mbikëqyrur dhe mbështetur institucionet vendore, të ndihmojë në procesin politik në përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, dhe në fazën finale mbikëqyrjen dhe transferimin e autoritetit në institucionet e themeluara vendore pas një zgjidhje politike si dhe mbështetje në rindërtimin e infrastrukturës dhe ekonomisë. Ndërsa, aspekti i sigurisë ishte përcaktuar të sigurohet përmes prezencës ndërkombëtare të sigurisë nën komandën direkte të Organizatës së Traktatit Veri-Atlantik (NATO)<sup>6</sup> që në teren u njoh me emrin Forca e Kosovës (KFOR) dhe ishte e shpërndarë në pesë kontingjente ushtarake të pesë rajoneve të Kosovës. Që nga viti 1999 deri më sot, KFOR-i vazhdon të ofroj siguri për të gjithë qytetarët e Kosovës. Në fillim të ndërhyrjes kishte afër 45000 trupa, ndërsa tani me një prani dukshëm më të vogël të pjesëtarëve të saj afërsisht rreth 5000 trupa. Administrata e Përkohshme Civile ndërkombëtare nën udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara (KB) themeloi Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të udhëhequr nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm(PSSP), ndërsa për të funksionuar më mirë dhe për të zbatuar mandatin e tij, formoi katër shtylla kryesore nën ombrellën e UNMIK-ut. Shtylla e parë (I)- Polici dhe Drejtësi dhe Shtylla e dytë (II)- Administratën Civile<sup>7</sup> nën udhëheqjen direkte të Kombeve të Bashkuara, Shtylla e tretë (III)- Demokratizimi dhe Ndërtimin e Institucioneve<sup>8</sup> nën udhëheqjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë(OSCE) dhe Shtylla e katërt (IV)- Rindërtimi dhe Zhvillimi Ekonomik<sup>9</sup> nën udhëheqjen e Bashkimit Evropian(BE). Të katër shtyllat e UNMIK-ut kanë funksionuar nën ombrellën udhëheqëse të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në Kosovë, por ndonëse PSSP ka drejtuar punën e të katër shtyllave, shtylla e III-të, Demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve nën udhëheqjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) ka punuar në mënyrë autonome brenda mandatit të saj, me buxhet autonom të udhëhequr në nivel ambasadori të caktuar nga qendra e saj vendimmarrëse në Vjenë. Gjithashtu edhe shtylla e IV-të është drejtuar nga Bashkimi Evropian dhe është udhëhequr nga përfaqësues të dërguar nga Bashkimi Evropian dhe politikat e koordinuara në Kosovë dhe buxheti i saj është bërë nga qendra vendimmarrëse në Bruksel. Bashkimi Evropian themeloi Agjencinë Kosovare të

---

<sup>6</sup> Po aty. neni 7.

<sup>7</sup> <http://www.unmikonline.org/civiladm/index.html>

<sup>8</sup> <http://www.osce.org/kosovo/>

<sup>9</sup> <http://www.euinkosovo.org/uk/about/about.php>

Mirëbesimit(AKM)<sup>10</sup> me qëllim që në Kosovë të rrisë vlerën, realizueshmërinë dhe udhëheqjen e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike,dhe privatizimin e tyre, e nga gushti i vitit 2008 u themelua Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit<sup>11</sup>.

Më vonë ky aktivitet karakterizohet me angazhimin e Bashkimit Evropian në kontributin për stabilitetin e Kosovës dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor para dhe pas përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës pas dështimit të një zgjidhje politike në nivel të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara(KSKB). Propozimi i Martti Ahtisaarit, të dërguarit special të Kombeve të Bashkuara për statusin përfundimtar, dështoi së miratuari në nivel të KSKB-së, përderisa propozimi ofronte një pavarësi të mbikëqyrur për Kosovën dhe një akomodim të mirë të minoriteteve brenda Kosovës.<sup>12</sup> Pasi që statusi politik i Kosovës kishte dështuar të zgjidhej në nivel të KSKB-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara e referoi atë si çështje Evropiane,<sup>13</sup> dhe pasi që statuskuoja në Kosovë ishte e paqëndrueshme, Këshilli i Bashkimit Evropian në pajtim të plotë me Sekretarin e Përgjithshëm të KB-së theksuan nevojën e ecjes para drejt një zgjidhje për Kosovën për një stabilitet rajonal.<sup>14</sup> Qëndrimi i Bashkimit Evropian dhe Përfaqësuesit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara i hapi rrugën Kosovës që në koordinim të plotë me komunitetin ndërkombëtar perëndimor, të shpallë pavarësinë më 17 Shkurt 2008.

Në anën tjetër, Bashkimi Evropian kishte ndërmarr hapin e duhur një vit më parë për të udhëhequr prezencën ndërkombëtare në Kosovë në mbikëqyrjen e periudhës pas përcaktimit të statusit përfundimtar. Një veprim i BE-së për udhëheqjen e prezencës ndërkombëtar në Kosovë pas statusit përfundimtar ishte i bazuar juridikisht si dhe ishte jetik për stabilizimin politik të Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor. Fillimisht, Bashkimi Evropian, duke stabilizuar Kosovën

---

<sup>10</sup> Zyra e AKM-së për privatizim e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike është themeluar më 13 Qershor 2002.

<sup>11</sup> <http://www.pak-ks.org/?page=1,5>

<sup>12</sup> Shih propozimin e të dërguarit special Martti Ahtisaarit për statusin përfundimtar të Kosovës, [http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal-english.pdf](http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf)

<sup>13</sup> Bllokimi i rezolutës së Kombeve të Bashkuara nga Rusia, ka detyruar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Ban Ki Mun, të referoj çështjen e Kosovës si çështje Evropiane. Dhe Bashkimi Evropian u zotua të zbatoj politikën e Jashtme dhe të Sigurisë në Kosovë për të ofruar paqe dhe siguri në rajon pas statusit përfundimtar të Kosovës.

<sup>14</sup> Council of European Union, *Presidency Conclusions*, Brussels, 14 December 2007, [http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms\\_Data/docs/pressData/en/ec/97669.pdf](http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/en/ec/97669.pdf)

ndikoi edhe në stabilizimin e tërë rajonit, ndërsa aftësia e udhëheqjes së procesit dhe prezencës ndërkombëtare në Kosovë nga Bashkimi Evropian shtoi besueshmërinë ndaj saj si faktor i mbajtjes së stabilitetit duke angazhuar funksionimin praktik të politikës së jashtme dhe të sigurisë për një problem politik brenda territorit gjeografik evropian. Kjo domosdoshmëri siguron paqe, stabilitet dhe siguri në rajon.

Pavarësia e Kosovës, në aspektin afatgjatë ka sjellë stabilitet për Kosovën dhe rajonin, ndërsa sigurimi i perspektivës evropiane për Kosovën dhe për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor vuri bazën për krijimin e një mirëqenie ekonomike dhe politike duke shikuar në drejtim të ardhmes së Evropës së bashkuar. Prandaj, Bashkimi Evropian, me të drejt, planifikoi dhe bëri parapërgatitjet për prezencën ndërkombëtare në Kosovë si dhe të Zyrës Civile Ndërkombëtare, të udhëhequr nga përfaqësuesi special i BE-së<sup>15</sup>, në mënyrë që të mbikëqyrë periudhën pas statusit përfundimtar të Kosovës. Vendimi i përbashkët i Këshillit të Bashkimit Evropian dhe qëndrimit të përbashkët të politikës së jashtme dhe të sigurisë (CFSP) është i bazuar në Traktatin e Bashkimit Evropian<sup>16</sup> për raste të veçanta në bazë të nevojës për veprim nga Bashkimi Evropian, e cila lejon vendosjen e një përfaqësuesi special të Bashkimit Evropian.

Kjo është edhe një dëshmi për rastin e veçantë të Kosovës. Përfaqësuesi special i BE-së kishte mandatin të udhëheqë me Zyrën Civile Ndërkombëtare, të këshillojë dhe mbështesë procesin politik, koordinon politikën e BE-së në Kosovë dhe të siguron udhëzime lidhur me politikën lokale për shëfën e misionit të EULEX-it në Kosovë dhe kompetencave ekzekutive të tyre.

Në anën tjetër, Misioni i ri i sundimit të ligjit në Kosovës i themeluar nga Bashkimi Evropian, misioni EULEX<sup>17</sup>, vepron nën Politikën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes Evropiane (PSME/ESDP) dhe ka mandatin për t'i ndihmuar autoritetet e Kosovës, autoritetet gjyqësore, policore si dhe të doganave për zhvillimin, forcimin për vetë-qëndrueshmëri, llogaridhënie dhe

---

<sup>15</sup> European Union, *Council Joint Action* of 15 September 2006 as last amended and extended by Joint Action on appointing a EUSR in Kosovo, Brussels, 4th of February 2008, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:042:0088:0091:EN:PDF>

<sup>16</sup> European Union, *Consolidated Version of the Treaty of the European Union*, articles 14, 18, 23, [http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/dat/12002M/pdf/12002M\\_EN.pdf](http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/dat/12002M/pdf/12002M_EN.pdf)

<sup>17</sup> European Union, *Council Joint Action on EU Rule of Law Mission in Kosovo*, Brussels, 4 February 2008, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:042:0092:0098:EN:PDF>

për të qenë apolitike në pajtim me standardet e njohura evropiane.<sup>18</sup> Sikurse përfaqësuesi special i BE-së<sup>19</sup> ashtu edhe shefi i misionit EULEX<sup>20</sup>, koordinuan politikat e implementimit të mandatit të tyre në Kosovë përmes Komitetit Politik dhe të Sigurisë(KPS/PSC), i cili siguroi udhëzime strategjike dhe politike në lidhje direkte me Këshillin e Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian kishte ndërmarrë një vendim të tillë në mungesë të gjetjes së një zgjidhje ndërkombëtare për Kosovën në nivel të KSKB-së, për të udhëhequr prezencën ndërkombëtare pas statusit përfundimtar dhe për të ofruar stabilitet si për Kosovën ashtu edhe për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Nga ky vendim i paluhatshëm i BE-së mund të konstatohet që Bashkimi Evropian mbetet i përkushtuar seriozisht për stabilitet rajonal, si parakusht i hapjes së rrugës për integrim evropian të të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe shtetin më të ri të Kosovës drejt integritetit të plotë në strukturat e Bashkimit Evropian.

### **1. 3. Proceset që i paraprinë vendosjes së EULEX-it në Kosovë**

Pas një konflikti të armatosur ndërmjet autoriteteve serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe pas një zhvendosje masive të popullatës civile, një numër në rritje të krimeve kundër njerëzimit dhe negociatave të dështuara për një zgjidhje paqësore të konfliktit, NATO ndërmori një fushatë 78-ditore ajrore kundër Serbisë duke filluar në fund të marsit të vitit 1999 që përfundimisht çojë në tërheqjen e forcave ushtarake dhe administratës serbe nga Kosova në bazë të marrëveshjes tekniko ushtarake të Kumanovës të arritur në mes NATO's dhe Serbisë. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSKB) 1244 e datës 10 qershor 1999 përcaktoi se një prani civile dhe ushtarake do të vendosej në Kosovë nën patronazhin e OKB-së. Misioni i Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK) përfaqësohej nga

---

<sup>18</sup> European Council, *on establishing EU Rule of Law mission and appointing EU special representative in Kosovo*, 16 February 2008, [http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms\\_Data/docs/pressData/en/gena/98768.pdf](http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/en/gena/98768.pdf)

<sup>19</sup> Council joint action, Brussels, 4<sup>th</sup> of February 2008, Article 4, Implementation of the mandate: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:042:0088:0091:EN:PDF>

<sup>20</sup> *ibid.* Article 12, Political Control and Strategic Direction

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP). PSSP-ja kishte të gjitha fuqitë ekzekutive dhe legjislative.

Pas një ngërçi politik në Kosovë Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Kofi Anan emëroi diplomatin Norvegjez Kai Eide si i dërguar i OKB-së për të vlerësuar gjendjen e përgjithshme në Kosovë. Pas konsultimeve që pati në teren, me liderë të të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfaqësues të lartë të vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit, të shteteve kryesore anëtare, sidomos atyre të grupit të kontaktit dhe të vendeve fqinje, si dhe me organizata rajonale (BE, OSBE, NATO dhe Këshilli i Evropës) si dhe me përfaqësuesit e UNMIK-ut në raportin e tij të dërguar OKB-së në vitin 2005 ai rekomandon fillimin e bisedimeve për statusin e ardhshëm të Kosovës duke thënë se nuk do të ketë një moment të mirë për të adresuar statusin e ardhshëm të Kosovës.

Pas kësaj, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, emëron ish presidentin Finlandës Martti Ahtisaarin Emisar Special për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Ai hapi një proces të bisedimeve intensive, nën drejtimin e Grupit të Kontaktit, duke përfshirë Francën, Gjermaninë, Italinë, Britaninë e Madhe, SHBA-të dhe Rusinë.

Paralelisht me fillimin e këtij procesi, brenda BE-së, Këshilli i Ministrave mirëpriti në dhjetor të vitit 2005 një raport të përbashkët nga Javier Solana Përfaqësuesi i Lartë dhe Komisionari Rehn për rolin e ardhshëm të BE-së dhe kontributin në Kosovë, në mesin e shumë masave të tjera, duhet të përgatiten për një mision të mundshëm të integruar të ESDP në Kosovë në fushën e sundimit të ligjit. Një Ekip Planifikues i BE me qëllim që të hapë rrugën për këtë mision u krijua në Prishtinë në prill të vitit 2006<sup>21</sup>.

---

<sup>21</sup> Raport i përbashkët nga Javier Solana, Përfaqësuesi i Lartë i BE për CFSP dhe Oli Rehn, Komisioner i BE për zgjerim, "Roli dhe kontributi i ardhshëm i BE-së në Kosovë "6 dhjetor 2005. 2006/304/CFSP Veprimi i Përbashkët i Këshillit të datës 10 prill 2006 për themelimin e Ekipit Planifikues të BE-së (EUPT Kosovë) lidhur me një të mundshëm të BE menaxhimin e krizës op bashkëpunimin në fushën e sundimit të ligjit dhe fusha tjera të mundshme në Kosovë, Gazeta Zyrtare L 112/18, 26 prill 2004.

Pakoja e Ahtisaarit u bë publike në mars të vitit 2007. Raporti rekomandoi pavarësi të mbikëqyrur, si i vetmi opsion i qëndrueshëm për Kosovën dhe ka përfshirë një shtojcë Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, ku përshkruhen parimet kryesore që mbështesin pavarësinë dhe strukturat mbikëqyrëse.<sup>22</sup> Ç'është më e rëndësishmja, sipas këtij plani, parashihej që një përfaqësues ndërkombëtar do të barte dy funksione, edhe atë si një Përfaqësues Civil Ndërkombëtar (ICR) edhe si Përfaqësues i BE (EUSR) për të mbikëqyrur zbatimin e marrëveshjes dhe i pajisur me kompetenca të fuqishme korrigjuese. Po ashtu ishte parashikuar që një mision i ESDP do të “monitorojë, udhëzojë dhe këshillojë” në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit në Kosovë dhe të veshur me autoritet ekzekutiv të kufizuar në fushat e drejtësisë, policisë dhe doganave. Serbia fuqishëm i kundërshtoi këto rekomandime dhe Rusia kërcënoi se do t'i vërë veton çdo përpjekje nga ana e KS të miratojë atë. Si rrjedhojë, KS të OKB dërgoi trojkën diplomatike SHBA-BE-Rusi të kryesuar nga ambasadori gjerman Wolfgang Ischinger për një përpjekje të fundit për të sjellë palët në një marrëveshje deri në fund të vitit 2007. Pas dështimit të “trojkës” për të identifikuar një zgjidhje konsensuale, rruga ishte e hapur për deklarin e pavarësisë nga ana e Prishtinës më 17 shkurt 2008. Më 4 shkurt, Këshilli i BE-së miratoi veprimin e përbashkët për vendosjen e EULEX-it në Kosovë dhe e emëroi diplomatin e lartë holandez Pieter Feith si Përfaqësues Special të Bashkimit Evropian (PSBE) në Kosovë.<sup>23</sup>

---

<sup>22</sup> Letra e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Presidentin e Këshillit të Sigurimit, UN doc. 5/2007/168, 26 mars 2007. Letra shoqërohet Raportin e të Dërguarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Statusin e Ardhsëm të Kosovës 'dhe' Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës ', UN doc. S/2007/168/Add

<sup>23</sup> Këshilli i Veprimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian 2008/124CFSP 4 shkurt 2008 për Misionin e Sundimit të Ligjit në Kosovë, Gazeta Zyrtare L42/92, 16 shkurt 2008 dhe Veprimi të Përbashkët të Këshillit 2008/123/CSFP i 4 shkurtit 2008, emërimit të një Përfaqësuesi Special të Bashkimit Evropian në Kosovë. Gazeta Zyrtare L 42/88, 16 shkurt 2008.



## KAPITULLI II

### MISIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË

#### 2. 1. Plani gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës i Presidentit Ahtisaari

Në fillim të vitit 2006 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Kofi Anan, emëroi përfaqësuesin e tij special ish Presidentin e Finlandës Martti Ahtisaari që t'i udhëheq bisedimet për gjetjen dhe zgjidhjen e statusit të Kosovës. Përderisa Këshilli i Sigurimit e kishte konfirmuar udhëheqjen e procesit të statusit nga OKB-ja, Grupi i Kontaktit do të vepronte si trup kontrollues për negociatat dhe për emisarin e posaçëm të OKB-së, Martti Ahtisaari. Grupi i Kontaktit miratoi dhjetë “Parimet, Udhëheqëse” për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Këto parime në esencë vendosën vijat e kuqe për t'u imponuar nga ndërmjetësit në negociata. Parimet kishin të bënin me: të drejtat e njeriut, vlerat demokratike, parimet e integriteteve euroatlantike, sigurinë, pjesëmarrjen në politikë të grupeve etnike, sigurimi i kthimit të refugjatëve dhe të zhvendosurve, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare, stabiliteti rajonal dhe zhvillimi ekonomik. Gjithashtu u bë e qartë, prerazi se nuk do të kishte kthim mbrapa në situatën që kishte ekzistuar në Kosovë para ndërhyrjes së NATO-s. Parimet udhëheqëse gjithashtu theksonin se “Cilado zgjidhje që është e njëanshme apo është pasojë e përdorimit të forcës do të ishte e papranueshme”. Përderisa GK i udhëhoqte negociatat, procesi ishte megjithatë zyrtarisht punë e OKB-së. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e emëroi jo vetëm emisarin e posaçëm, Martti Ahtisaari, por edhe zëvendësin e tij Albert Rohanin e Austrisë, i cili i udhëhoqi bisedimet. Ndërmjetësit e negociatave ishin të përcaktuar nga një sekretariat, nga zyra e OKB-së e emisarit të posaçëm për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës (UNOSEK). Pas një varg raundesh të bisedimeve në Vjenë me datën 26 mars të vitit 2007 ai paraqiti raportin e tij për zgjidhjen e statusit të Kosovës të njohur si “Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës.”<sup>24</sup> Në aneksin IV të këtij plani gjithëpërfshirës ishte paraparë edhe një Mision i Bashkimit Evropian si

---

<sup>24</sup> Propozimi gjithëpërfshirës për vendosjen e statusit të Kosovës i ish Presidentit Finlandez Marti Ahtisari 26 Mars 2007.

një trashëgimtare e UNMIK-ut, përmes Misionit të Sundimit të Ligjit dhe Zyrës së Përfaqësuesit Civil të Bashkimit Evropian, Mision që do të ndihmonte institucionet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit. Marrëveshja përfshinë dispozita specifike që të sigurojë se sistemi i drejtësisë është i integruar, i pavarur, profesional dhe i paanshëm. Ofron mekanizma që të arrihet sistemi i drejtësisë që është përfshirës për të gjitha komunitetet, dhe në të cilin gjyqësori dhe shërbimi prokurorial reflekton karakterin multietnik të Kosovës. Për më tepër ky plan parasheh që të gjithë të kenë qasje në sistemin e drejtësisë. Neni 143 (Propozimi Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës) thotë se:

1. Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës të datës 26 Mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.

2 . Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës të datës 26 Mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.

3. Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimi Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës të datës 26 Mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë.

## 2. 2. Baza ligjore e Misionit

EULEX-i është misioni më i madh civil i ndërmarrë ndonjëherë nga Politika e Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje e BE-së (PBSM). Synimi kryesor është ofrimi i ndihmës dhe i mbështetjes në fushën e sundimit të ligjit për autoritetet e Kosovës, në mënyrë të veçantë sektorit të policisë, të gjyqësorit dhe të doganës. Ky mision nuk ka për qëllim të qeverisë me Kosovën apo ta sundojë atë. Është një mision teknik i cili monitoron, udhëzon dhe këshillon, duke mbajtur disa kompetenca të kufizuara ekzekutive. EULEX-i është themeluar në rrethana unike dhe komplekse politike, të cilat kanë pasur implikime juridike vendore dhe ndërkombëtare për funksionimin e misionit. EULEX-i është dashur që vendosjen e vet ta bëjë të pranueshme për të dyja, Kosovën dhe Serbinë<sup>25</sup>. Nga këndvështrimi i Kosovës, prania e EULEX-it është arsyetuar ligjërisht dhe praktikisht duke iu referuar Deklaratës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, planit të Ahtisaarit si dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të tria këto të refuzuara dhe të papranueshme për Serbinë. Ndërsa nga këndvështrimi i Serbisë, prania e EULEX-it është arsyetuar në bazë të pranimi të këtij të fundit për të vepruar në bazë të mandatit "neutral ndaj statusit" dhe për të marrë pjesë në zbatimin e Planit Gjashtë Pikësh të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (SPKB), të dyja këto të refuzuara nga dhe të papranueshme për Kosovën. Ndërlikimet buronin nga fakti se gjendja në terren pati ndryshuar në mënyrë ekstreme midis fazës së planifikimit të vendosjes dhe vendosjes së vërtetë<sup>26</sup>. Faza e planifikimit kishte filluar më 10 prill 2006 me krijimin e Ekipit Planifikues të BE-së (EUPT), që synonte sigurimin e tranzicionit të qetë të përgjegjësive nga misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) tek misioni i ardhshëm i Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë. Ndërlikimi i periudhës, në të cilën pati filluar faza e planifikimit ishte se: (1) EUPT ishte themeluar me pak se dy muaj pasi kishin nisur bisedimet për statusin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Vjenë, dhe (2) se ishte parashikuar që bisedimet do të përfundonin me një marrëveshje ndërmjet palëve që si rezultat do të siguronin një tranzicion të qetë të përgjegjësive nga UNMIK-u dhe një shtrirje të pandërprerë të EULEX-

---

<sup>25</sup> Interviste me Zv.shëfën e Misionit të Bashkimit Evropian (EULEX) Prishtinë më 2 Shkurt 2012

<sup>26</sup> Po aty.

it. Në fund, bisedimet për statusin dështuan<sup>27</sup>; duke hequr kështu një kartë domino të rëndësishme në synimet fillestare të misionit, gjatë fazës së tij të planifikimit.

Refuzimi i Serbisë për Planin e Ahtisaarit qoi në refuzimin e Rusisë për ta miratuar atë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Duke qenë se Plani i Ahtisaarit parashihte vendosjen e një misioni të Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje (ESDP) në Kosovë, mungesa e konsensusit për Planin e Ahtisaarit në KS të OKB-së, nënkuptonte se do të ketë ndarje brenda BE-së nëse misioni duhet apo jo të shtrihet në përputhje me Planin e Ahtisaarit, i cili propozoi që Kosova të bëhet një shtet i pavarur me mbikëqyrje ndërkombëtare. Gjithashtu, u bë e qartë se dështimi për ta miratuar Planin në KS të OKB-së do ta qojë Kosovën kah shpallja e pavarësisë së saj në mënyrë të njëanshme në përputhje me Planin dhe në koordinim me partnerët e saj perëndimorë. Vendosja e misionit në një Kosovë të pavarur siç parashihej me Planin e Ahtisaarit do të rrezikonte që disa nga shtetet anëtare të BE-së të bllokojnë vendimin në Këshill, pasi disa prej tyre e shihnin këtë si një shkelje të hapur të Rezolutës 1244 të KS të OKB-së.<sup>28</sup> Duke e pranuar këtë fakt, BE-ja nxitoi që të miratojë vendimin për vendosje para se Kosova të shpallte pavarësinë e saj, në mënyrë që ta përdorte Rezolutën 1244 të KS të OKB-së si bazë të pranueshme juridike për të gjitha shtetet anëtare.<sup>29</sup> Kjo u bë përmes Veprimit të Përbashkët për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë- EULEX Kosovë, të datës 4 shkurt 2008.<sup>30</sup>

Siç u theksua edhe më lartë në aneksin IV të Planit Gjithëpërfshirës të Martti Ahtisaarit ishte paraparë edhe vendosja e një Misioni të Bashkimit Evropian që do të pasonte UNMIK-un me një mision për sundimin e rendit dhe ligjit në Kosovë më vonë të njohur si EULEX. Kështu që Bashkimi Evropian u vu në lëvizje për të përgatitur bazën ligjore dhe funksionimin e prezencës së ardhshme të saj në Kosovë. Përmes vendimit të Këshillit për Veprim të Përbashkët 2006/304/CFSP të datës 10 prill 2006 u vendos për themelimin e Ekipit Planifikues të BE-së (EUPT Kosovë) lidhur me një mision të mundshëm të BE-së në menaxhimin e krizës apo bashkëpunimin në fushën e sundimit të ligjit dhe fusha tjera të mundshme në Kosovë. Kjo bëri të

---

<sup>27</sup> Deklarata e shpalljes se pavaresise se Kosoves, me 17 shkurt 2008.

<sup>28</sup> Rezoluta 1244 e OKB-se

<sup>29</sup> Robert Muharremi, "The European Union Rule of Law Mission in Kosovo(EULEX) from the Perspective of Kosovo Constitutional Law," 2010

<sup>30</sup> Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP, 4 shkurt 2008

mundur sjelljen e një numri të personelit nga Brukseli dhe përgatitjeve në teren për vendosjen e një Misioni Evropian. Pas zhvillimit të ngjarjeve në terren dhe përgatitjeve së terrenit për misionin e ri përmes vendimit të Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP i datës 04 Shkurt 2008 u vendos themelimi i Misionit për Sundimin e Ligjit të Bashkimit Evropian në Kosovë, EULEX i cili shërbeu si bazë ligjore për misionin. Po ashtu si bazë ligjore shërbeu edhe rezoluta 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe ftesa e institucioneve vendore të Kosovës e cila buronte nga deklarata e pavarësisë ku i bëhej ftesë Bashkimit Evropian të vendos misionin e saj në Kosovë që do të ndihmonte institucionet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit<sup>27</sup>. Në Deklaratën e saj të Pavarësisë, Kosova ka mirëpritur "mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin (e saj) demokratik nëpërmjet pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999)."<sup>31</sup> Ajo gjithashtu kishte ftuar dhe mirëpritur një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi Evropian.<sup>32</sup> Kjo, në një masë të caktuar, i ka dhënë pranisë së EULEX-it një nivel të legjitimitetit.<sup>33</sup> Fundi i mbikëqyrjes së pavarësisë më 10 shtator 2012 dhe mbyllja përfundimtare e Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO) çoi deri tek ndryshimet kushtetuese, që do të reflektonin largimin e ICO-së dhe transferimin e përgjegjësisë të PCN-së mbi autoritetet lokale. Përpos që baza ligjore e EULEX-it nuk ndryshoi, lindën pyetje në lidhje me vazhdimin e rolit dhe mandatit të misionit në realitetin e ri të Kosovës dhe rregullimin kushtetues. Ka pasur propozime që EULEX-i duhet të integrohet në Kushtetutën e Kosovës<sup>34</sup>, por një propozim të tillë Qeveria e Kosovës (QK) e mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë<sup>35</sup> nuk e miratoi idenë për futjen e EULEX-it si pjesë përbërëse të Kushtetutës së Kosovës, por u pajtua që baza ligjore e misionit të themelohet me një letër-këmbim midis Presidentes së

---

<sup>31</sup> Deklarata e Pavarësisë, shënimi 5, 17 shkurt 2008

<sup>32</sup> Deklarata e Pavarësisë, shënimi 5, 17 shkurt 2008

<sup>33</sup> Shënim: Autoritetet e Kosovës e shohin mandatin e EULEX-it siç parashihet në Planin e Ahtisaarit, derisa EULEX-i nuk e bazon praninë e vet në asnjë dokument ligjor të Kosovës, as në Deklaratën e Pavarësisë, as në Planin e Ahtisaarit, dhe as në Kushtetutën e Republikës së Kosovës

<sup>34</sup> Kërkohet futja e EULEX-it në Kushtetutë," KohaNet,4 korrik 2012, <http://www.koha.net/?page=1,13,105829> (7 dhjetor 2012)

<sup>35</sup> KIPRED intervistë me zyrtar të lartë nga Presidenca e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 7 janar 2013.

Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të CFSP-së.<sup>36</sup> Në letrën e saj të datës 4 shtator 2012, Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, e ftoi Përfaqësuesen e Lartë të CFSP-së, Catherine Ashton, që të përgjigjet me gatishmërinë e BE-së që të vazhdojë dërgimin e personelit për të shërbyer si pjesë e EULEX-it.<sup>37</sup> Gjatë ftesës së saj, Presidentja e Kosovës i është referuar Kushtetutës së Kosovës, kur ka përmendur si autoritetin e saj ashtu edhe përshtatjen e EULEX-it në rregullimin juridik dhe gjyqësor të Kosovës. Më 7 shtator 2012, Kuvendi i Kosovës votoi ftesën e Presidentes për EULEX-in në formë të ligjit, duke e quajtur si "marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë"<sup>38</sup>, në mënyrë që të krijoj një bazë "të mjaftueshme" të brendshme ligjore për vazhdimin e veprimit të misionit. Krahasuar me ftesën e mëparshme, e cila ishte miratuar si pjesë e pakos së Deklaratës së Pavarësisë; miratimi i pranisë së EULEX-it me dy të tretat e votave në Kuvend si një çështje të vetme ka forcuar legjitimitetin e tij. Edhe pse Kuvendi i Kosovës ka ratifikuar ftesën si një marrëveshje ndërkombëtare, ajo nuk mund të konsiderohet si marrëveshje për shkak të faktit se Bashkimi Evropian nuk e ka ratifikuar të njëjtën marrëveshje siç e ka bërë Kosova me procedurat e përcaktuara;<sup>39</sup> megjithatë, ajo paraqet disa hapa përpara të ndërmarra nga ana e Kosovës si përpjekje për të forcuar legjitimitetin dhe bazën ligjore të EULEX-it. EULEX-i në parim mban një qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës për shkak të kundërshtimit të ashpër të Serbisë por edhe për shkak të mos unitetit Brenda Bashkimit Evropian ku 5 nga shtetet anëtare nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

<sup>36</sup> EULEX-i nuk do të futet në Kushtetutë," Telegrafi, 7 korrik 2012, <http://www.telegrafi.com/lajme/eulex-i-nukdo-te-futet-ne-kushtetute-2-23677.html> (1 dhjetor 2012)

<sup>37</sup> Ftesa nga Presidentja Atifete Jahjaga drejtuar Catherine Ashton HREU, 4 shtator 2012.

<sup>38</sup> Kuvendi i Rep. së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-148, Prishtinë, 7 shtator 2012. <http://www.assemblykosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%2004-L-148.pdf>

<sup>39</sup> Versioni i Konsoliduar i Traktatit mbi BE-në dhe TFEU, Titulli V <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2010:083:FULL:EN:PDF>

### 2. 3. Mandati dhe kompetencat

Sipas deklaratës së misionit në nenin 2 të Veprimit të Përbashkët, EULEX-i në Kosovë "do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë e zbatimit të ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë dhe në zhvillimin e mëtejshëm dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumetnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione janë të lira nga ndërhyrja politike dhe respektimi të standardeve të pranuara ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira evropiane.<sup>40</sup>

Veprimi i Përbashkët mandej përktheu mandatin e misionit në një numër te detyrave operationale horizontalisht për të tre komponentët e ndryshme të EULEX-it, d.m.th. e drejtësisë, policisë dhe doganor. EULEX-i është të sigurojë që rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit të organizuar, korrupsionit, krimeve ndëretnike krimeve ekonomike/financiare dhe krimeve tjera serioze, si dhe çështjet të lidhura me pronat të hetohen, ndiqen, gjykohen dhe zbatohen sipas ligjit të aplikueshëm, të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit gjatë gjithë procesit gjyqësor, veçanërisht në fushën e krimit të organizuar si dhe të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit, mashtrimit dhe krimit financiar<sup>41</sup>. Përveç kësaj, ka një rëndësi të përgjithshme klauzola për detyrat e mbetura të dyja të natyrës ekzekutive dhe jo-ekzekutive. Në të vërtetë, Veprimi i Përbashkët përcakton se EULEX-i mund të marrë përsipër përgjegjësi të tjera, pavarësisht apo në përkrahjen e autoriteteve kompetente të Kosovës, për të siguruar mirëmbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë.<sup>42</sup> Kjo dispozitë është interpretuar si më poshtë: Detyrat e mundshme shtesë ekzekutive janë bashkangjitur në nocionin 'Pavarur' ndërsa jo-ekzekutive detyrave të mentorimit, monitorimit dhe këshillimit - janë të mbuluara nga 'në mbështetje të autoriteteve kompetente të Kosovës. Më sa duket, kjo klauzolë është shtuar për të shmangur nevojën që të ndryshojë Mandati i misionit, duke pasur parasysh vështirësitë me të cilat padyshim do të lindin në mënyrë që të arrihet marrëveshja në këtë drejtim. Veprimi i Përbashkët thjesht i referohet ruajtjes së disa përgjegjësi ekzekutive të

---

<sup>27</sup> Council Joint Action 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX Kosovo, OJ 2008 L 42 Article 2

<sup>41</sup> Po aty

<sup>42</sup> Po aty

caktuara, ndërsa monitorimi, mentorimi dhe këshillimi i institucioneve kompetente kosovare në të gjitha fushat që ndërlidhen me sundimin e ligjit (përfshirë shërbimin doganor).

Ndoshta një analizë e thjeshtë tekstuale e mandatit do të çojë në konkluzionin se aspekti i tij ekzekutiv është i drejtuar kryesisht drejt ndihmës për gjyqësorin dhe policinë e Kosovës në përparimin e tyre drejt institucioneve të qëndrueshme. Për më tepër EULEX-i ka fuqinë për të ndryshuar ose të anulojë vendimet operative të marra nga autoritetet kompetente të Kosovës në konsultim me autoritetet relevante civile ndërkombëtare në Kosovë, në rast se kjo dëshmohej e nevojshme për mirëmbajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe të sigurisë.<sup>43</sup> Në përmbushjen e detyrave të tij, EULEX-i sigurohet që të gjitha aktivitetet e veta të respektojnë standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. Në mënyrë që të arrihen objektivat në bazë të qasjes së zgjedhur, lidhshipi i misionit vazhdimisht punon drejt sigurimit të planifikimit solid strategjik dhe në koordinim të ngushtë me autoritetet lokale në të gjitha nivelet e ndryshme të hierarkisë dhe në të gjitha fazat e ndryshme gjatë procesit të planifikimit. Organi më i lartë në nivelin e autoritetit politik në këtë drejtim është Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPBSL), i themeluar pikërisht për këtë qëllim<sup>44</sup>. BPBSL është një trup i përbërë prej autoriteteve të Kosovës nga fusha e sundimit të ligjit, EULEX-it dhe Zyrës së BE-së dhe është i bashkë-kryesuar nga Shefi i Misionit të EULEX-it dhe zëvendës kryeministri i Kosovës. Ndërsa përbërja e tij e saktë ndryshon sipas rendit të ditës, takimet janë të përbëra shpesh nga kryesuesit e EULEX-it për komponentin e Drejtësisë, Policisë dhe Zyra e Programit, si dhe shefit të zyrës ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE) dhe nga përfaqësues të ministrave të Kosovës të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme<sup>45</sup>. Figura e paraqitur më poshtë tregon organigramin e EULEX-it në fillim të mandatit të tij.

---


<sup>43</sup> Po aty

<sup>44</sup> In order to ensure overall strategic coordination of efforts between the authorities in Kosovo (including the ministers of Justice, Internal Affairs, Economy and Finance) and EULEX, the Joint Rule of Law Coordination Board, to be co-chaired by the local authorities and the EULEX Head of Mission, has been established. See Security Council, "Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo", S/2009/149, 17 March 2009, Annex I, report of the SG/HR for CFSP to the UNSG on the activities of the European Union Rule of Law Mission in Kosovo.

<sup>45</sup> Intervistë me Zv.shefin e Misionit të Bashkimit Evropian (EULEX) Prishtinë më 2 Shkurt 2012



**Figura.1. Organigrami i EULEX-it në vitin 2008**



Në qershor 2010, ky Mision në Kosovë u vazhdua për një periudhë prej dy vitesh. Objektivat kryesore të tij mbetën të njëjta. Vazhdimi i mandatit të EULEX-it në vitin 2012 u shoqëruar me një reduktim të konsiderueshëm të personelit dhe ristrukturim të Misionit. Ky Mision u rikonfigurua në dy sektorë kryesorë: Sektori Ekzekutiv, i cili punoi në mandatin ekzekutiv të misionit dhe Sektori për Fuqizim, i cili përqendrohet në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e homologëve vendas.

Vazhdimi i mandatit të Misionit në qershor 2014 ka sjellë ndryshime të mëdha, ndërsa katër objektivat operativ kanë mbetur të njëjtë (monitorimi, mentorimi dhe këshillimi, mandati ekzekutiv, veriu dhe mbështetja për dialogun. Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë i ndryshuar me anë të Ligjit Nr. 04/L-273 (tani quhet: Ligji mbi juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë), përbërja e trupave gjykues do të jetë me shumicë të kosovarëve dhe pakicë të ndërkombëtareve. Ky Mision nuk do të merr përsipër raste të reja dhe gradualisht do t'ia bart kompetencat sistemit gjyqësor të Kosovës. Përfundim për këtë është veriu i Kosovës, ku EULEX-i do të vazhdojë të jetë përgjegjës për procedurat gjyqësore derisa Dialogu i lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit të mos sjellë ndonjë zgjidhje për drejtësinë.


Marrëveshja e muajit qershor 2014 mbështetet në shkëmbimin e letrave ndërmjet Presidentes Atifete Jahjaga dhe Përfaqësueses së lartë të BE Catherine Ashton më 14 prill 2014.

Pas kësaj u modifikua mandati aktual i EULEX-it dhe për pasojë është reduktuar edhe më tej numri i personelit të tij, nga 1250 staf ndërkombëtar në 800 (një ulje prej 36%) dhe nga 1000 staf vendor në 800 (një ulje prej 20%).

EULEX-i e ka ruajtur strukturën themelore të tij, d.m.th. dy sektorët kryesorë “Ekzekutiv” dhe “Fuqizim”. Këtij Misioni i është ngarkuar edhe detyra për të ndihmuar në zbatimin e marrëveshjeve të arritura në kuadër të dialogut Beograd – Prishtinë dhe të inkorporuar në ‘Marrëveshjen e parë ndërkombëtare mbi parimet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë’ të nënshkruar më 19 prill 2013. Mandati aktual i EULEX-it skadon më 14 qershor 2018. Ristrukturimi i fundit që ka ndodhur nga qershori i vitit 2016 deri më 14 nëntor 2016 shënon një reduktim shumë të madh të stafit, ku tani gjithsej misioni ka afër 800 punonjës.

Figura e paraqitur më poshtë tregon ristrukturimin e misionit të EULEX-it në vitin 2016.

**Figura 2. Ristrukturimi i misionit të EULEX-it në vitin 2016.**



Sipas mandatit të ri të Misionit 2016-2018, gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it vazhdojnë të jenë të bashkë-vendosur në institucionet e Kosovës dhe të shërbejnë në pajtueshmëri me ligjin e Kosovës deri sa të bëhet transferimi i plotë i funksioneve tek autoritetet kompetente të Kosovës. Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it bëjnë ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve në kuadër të drejtës kushtetuese, civile (kontestet pronësore dhe çështjet e privatizimit), si dhe lëndët e

përzgjedhura penale shumë të ndjeshme (krime të luftës, terrorizmin, krimet ndër-etnike, krimin e organizuar dhe korrupsionin), ekskluzivisht dhe së bashku me homologët e tyre kosovarë. Ndërsa, të gjitha lëndët për të cilat EULEX-i nuk ka më juridiksion prej 15 prillit 2014, do të vazhdojnë të trajtohen ekskluzivisht nga autoritetet gjyqësore dhe prokuroriale të Kosovës. Kryeprokurori i EULEX-it i identifikon lëndët që janë në proces, të cilat mund t'ju barten organeve të ndjekjes të Kosovës. Disa prej këtyre lëndëve do të monitorohen nga Sektori i Fuqizimit. Në rrethana të jashtëzakonshme të përkufizuara me ligj, Kryeprokurori i EULEX-it është kompetent që të kërkojë që lëndët e reja t'ju caktohen prokurorëve të EULEX-it. Po kështu, kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it mund të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, që gjyqtarët e EULEX-it të jenë të pranishëm në trupat gjykues për rastet në proces apo të reja. Lëndët e përbashkëta hetohen dhe ndiqen penalisht nga ekipe të përziera të përbëra nga autoritetet e ndjekjes të Kosovës dhe prokurorët e EULEX-it. Në këto raste, Sektori Ekzekutiv i mentoron homologët e tyre kosovarë në formë të bashkëpunimit me kolegët e nivelit të njëjtë. Sapo të emërohet dhe të integrohet personeli gjyqësor në Gjykatën dhe Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, të gjitha lëndët e EULEX-it në rajonin e Mitrovicës do të konsiderohen si lëndë të përbashkëta. Në fushën e të drejtës civile, mandati i gjyqtarëve të EULEX-it është i kufizuar në lëndët që bëjnë pjesë në juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Përveç kësaj, Sektori Ekzekutiv është përgjegjës për rastet që bëjnë pjesë në juridiksionin e Paneleve të Apelit lidhur me vendimet e Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës. Me strukturën e re të Misionit, zëvendës-shefi i Sektorit Ekzekutiv të Policisë është përgjegjës për zbatimin e mandatit të Misionit në fushën e policisë ekzekutive. Ekspertët e forenzikës të EULEX-it të vendosur në Institutin e Mjekësisë Ligjore, i kryejnë funksionet e tyre ekzekutive për zgjidhjen e rasteve të personave të pagjetur në Kosovë. Roli ekzekutiv i Misionit do të zvogëlohet gradualisht me zhvillimin e institucioneve të Kosovës për sundimin e ligjit dhe me marrjen e më shumë përgjegjësi në këto fusha nga ana e tyre. Sektori Ekzekutiv e mbështet zbatimin e praktikave më të mira evropiane lidhur me të drejtat e njeriut dhe me parimet e tjera përkatëse ligjore. Ky Sektor punon për t'i mbështetur autoritetet e Kosovës me bashkëpunim ndërkombëtar lidhur për çështjet policore dhe të drejtësisë.<sup>46</sup>

---

<sup>46</sup> <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,2>

Sektori i Fuqizimit (SF), në bashkëpunim të plotë dhe të ngushtë me akterët e tjerë të BE-së në skenë, i mbështetë në nivel të lartë menaxherial institucionet e Kosovës për sundim të ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies. Në thelb ky sektor ka për synim fuqizimin e mëtejme të zinxhirit të drejtësisë penale, me theks luftimin e ndërhyrjes politike, përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit. Kjo përfshin monitorimin e rasteve të caktuara dhe ofron mbështetje për dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës përmes ofrimit të asistencës për zbatimin e marrëveshjeve të mbetura të dialogut në sferën e sundimit të ligjit. Sektor për Fuqizim vepron ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe me Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Sektori i fuqizimit monitoron raste të caktuara të Kosovës të cilat kanë të bëjnë me krimet e rënda, siç janë korrupsioni, krimi i organizuar, krimet ndëretnike dhe krimet e luftës, përmes zinxhirit të drejtësisë penale dhe ofron këshilla lidhur me ndjekjen penale dhe hetimin e këtyre krimeve. Përveç kësaj, ky sektor ofron mbështetje të strukturuar për zhvillimin e mëtejme të kapaciteteve dhe aftësive të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Poashtu e mbështetë Shërbimin Korrektues të Kosovës me kapacitete mobile për t'u përqendruar në trajtimin e të burgosurve të profilit të lartë, menaxhimin e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit, përfshirë Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë. Ky sektor gjithashtu e mbështetë menaxhmentin e lartë të Policisë së Kosovës (PK), përfshirë kapacitete mobile për policinë për shqyrtimin e mangësive strukturore dhe organizative në përmirësimin e shënjestrimit të kriminalitetit të rëndë, përfshirë terrorizmin, korrupsionin, krimin e organizuar, dhe për njësitë e specializuara. Po ashtu ofron monitorim, mentorim dhe këshillim Komandës Rajonale të PK-së në Veri dhe stacioneve të saj të policisë. Monitoron dhe asiston Policinë Kufitare të Kosovës/Doganën e Kosovës për zbatimin e strategjive të Kosovës për Menaxhimi i Integruar i Kufirit (MIK) dhe strategjive për migrim, si dhe marrëveshjeve për lirinë e lëvizjes, dhe aktivitetet e përbashkëta me FRONTEX.

SF e mbështetë Agjencinë e Regjistrimit Civil në zbatimin e marrëveshjeve të dala nga dialogu Beograd-Prishtinë. Sektori për Fuqizim përbëhet prej katër njësive: Njësia Këshilluese për Çështje Policore dhe Doganore, Njësia këshilluese për Çështje të brendshme, njësia këshilluese për drejtësinë dhe shërbimet korrektuese<sup>47</sup>.

---

<sup>47</sup> <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,3>

## **2.4. Roli i komponentes se policisë, doganave dhe drejtësisë në përkrahjen e mbajtjes se rendit dhe sundimit te ligjit në Kosovë**

Komponenti i Policisë luan një rol shumë të rëndësishëm brenda misionit. Personeli është i strukturuar sipas detyrave të tyre përkatëse në tri departamente: Departamenti fuqizues, Departamenti i policisë ekzekutive, dhe Departamenti i policisë speciale.

Komponenti i Policisë është pjesë e mbështetjes së përgjithshme të EULEX-it për autoritetet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit. EULEX-i ndihmon Policinë e Kosovës (PK), për të punuar drejt një policie shumë-etnike që është e lirë nga ndërhyrjet politike dhe i shërben popullit të Kosovës.<sup>48</sup> Komponenti i Policisë është njëherësh edhe komponenti më i madh dhe i cili cilësohet si më i suksesshmi në punën e tij.

Sipas mandatit të ri të Misionit, zëvendës-shëfi i Sektorit Ekzekutiv të Policisë është përgjegjës për zbatimin e mandatit të Misionit në fushën e policisë ekzekutive. Ai është homolog i drejtpërdrejtë i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Policia e EULEX-it e mbështetë hetimin dhe ndjekjen e rasteve penale të ndjeshme të EULEX-it. Ajo vazhdon me Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe mban kontakte me autoritetet policore në rajon dhe jashtë tij, duke përfshirë EUROPOL-in dhe INTERPOL-in. Policia e EULEX-it i ofron ndihmë edhe Institutit të Mjekësisë Ligjore. Njësia e specializuar e saj në mënyrë të kufizuar angazhohet në raste të incidenteve gjatë trazirave publike dhe e ndihmon Njësinë e Policisë së Kosovës për kontrollin e turmave dhe trazirave.<sup>49</sup>

Ndërsa, në Sektorin për fuqizim, policia e EULEX-it vepron ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe me Shërbimin Korrektues të Kosovës. Sektori monitoron raste të caktuara të Kosovës të cilat kanë të bëjnë me krimet e rënda, siç janë: korrupsioni, krimet e organizuara, krimet ndëretnike dhe krimet e luftës, përmes zinxhirit të drejtësisë penale dhe ofron këshilla lidhur me ndjekjen penale dhe hetimin e

---


<sup>48</sup> Komponenti Policor i EULEX-it, 03 Maj 2011, i disponueshëm në: (<http://www.eulex-kosovo.eu/en/police/>) (25/05/2011).

<sup>49</sup> <http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,2>

këtyre krimeve. Por EULEX-i gjithashtu ka disa kompetenca korigjuese në lidhje me punën e PK-së, si pjesë e mandatit të tij ekzekutiv. Hetimet policore dhe operacionet që bien nën mandatin ekzekutiv të EULEX-it (korrupsioni i nivelit të lartë, krimin të organizuar, krimeve të luftës etj) janë duke u ekzekutuar nga Policia e EULEX-it. Policia e EULEX-it ka marrë pjesë në arrestimin e të dyshuarve për krimet e luftës si dhe në rastet e personave të profilin të lartë të përfshirë në korrupsion dhe krim të organizuar.

Komponenta e policisë ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në komunat veriore të Kosovës me shumicë serbe. Autoritetet e Kosovës kanë pasur vështirësi në vendosjen e rendit dhe ligjit në këtë rajon, po ashtu kanë dhënë një kontribut shumë të madh në implementimin e marrëveshjes të arritur në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në fushën e policisë ku pjesëtarët e EULEX-it kanë ndihmuar në procesin e rekrutimit në policinë e Kosovës të strukturave paralele të sigurisë të njohura edhe me emrin mbrojtja civile.


**Figura 3. Komponenta e policisë**



Një komponentë mjaft e rëndësishme e cila ndikon drejtpërdrejtë në uljen e nivelit të krimin të organizuar është komponenti i doganave të EULEX-it. Doganat kanë shënuar një progres të madh në përmirësimin e performancës dhe luftimin e kontrabandës. Por, ende në Kosovë ka kontrabandë të madhe e cila është multietnike, por në fakt duket se pjesa më e madhe e saj, i ka burimet nga veriu i Kosovës, dhe këtu EULEX-i ka pasur një rol të rëndësishëm në

parandalimin dhe luftimin e saj. Po ashtu me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës pikat doganore në veriun e Kosovës, përkatësisht në pikat kufitare në Jarinje dhe Bërnjak ishin djegur nga ekstremist të komunitetit serb dhe se ishte e pamundur për doganieret dhe policinë kufitare të Kosovës që të ushtronin detyrën e tyre në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Këtë detyrë e kanë kryer doganierët e EULEX-it për një kohë e më vonë kanë bërë edhe bartjen e doganierëve të Kosovës përmes helikopterëve pasi nuk kishte siguri për të arritur në pikat kufitare përmes rrugëve tokësore. Për rrezikun që ishte të arrihej në pikat kufitare në veri më së miri e tregon edhe rasti i vrasjes së zyrtarit doganor të EULEX-it Audrius Šenavičius gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Prania e EULEX-it në dogana ka qenë jashtëzakonisht e dobishme në mbrojtjen e pavarësisë së institucionit. Është raportuar se presioni politik mbi institucionin është bërë shumë më pak i mundshëm për shkak se zyrtarët e lartë të Doganave të Kosovës kanë pasur frikë se mund të ndiqen nga EULEX-i.<sup>50</sup>

**Figura 4. Komponenta e doganave.**



Gjyqtarët e EULEX-it përfaqësojnë një pjesë përbërëse të Komponentit të Drejtësisë së Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Gjyqtarët e EULEX-it janë shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian ose të shteteve të tjera kontribuese (Norvegjia, Zvicra, Turqia, Kroacia, ShBA-ja dhe Kanadaja), të cilët janë gjyqtarë aktivë në vendet e tyre të origjinës. Për shkak të natyrës specifike të funksioneve të tyre, krahas monitorimit, udhëzimit

<sup>50</sup>

KIPRED intervista të ndryshme me zyrtarë doganorë, Prishtinë, 30 nëntor 2012

dhe këshillimit të homologëve të tyre vendorë, gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë edhe funksione ekzekutive, në përputhje me Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë<sup>51</sup>.

Gjyqtarët e parë evropianë në Kosovë arritën në prill të vitit 2008. Më 10 korrik 2008 u mbajt Asambleja e parë e gjyqtarëve të EULEX-it. Asambleja e gjyqtarëve është përgjegjëse për menaxhimin e punës së gjyqtarëve të EULEX-it. Si punë të parë, Asambleja ka miratuar Udhëzimet për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndët penale dhe civile në ish gjykatat e qarkut dhe komunale respektivisht me rregullimin e ri të sistemit gjyqësor ato quhen gjykata themelore. Më 23 tetor 2008 seanca e dytë e Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it, me pjesëmarrjen e 17 gjyqtarëve, finalizuan Udhëzimet për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në lëndët penale në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Udhëzimet organizative për ekipet e gjyqtarëve të EULEX-it. Këto rregulla dhe udhëzime të përfunduara deri në asamblenë e parë dhe të dytë kanë vënë bazamentin për organizimin e funksioneve të ardhshme gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it. Deri në fillim të dhjetorit 2008, ishin përcaktuar aspekte të ndryshme të menaxhimit të punës së ekipeve të gjyqtarëve të EULEX-it, duke përfshirë caktimin e personave kontaktues administrativë për secilën gjykatë, përbërjen e trupave gjyqësore, identifikimin e lëndëve të pazgjidhura penale dhe civile që duhet të gjykohen nga gjyqtarët e EULEX-it, dhe organizimin e shqyrtimeve gjyqësore. Po ashtu janë përpiluar udhëzimet për ngritjen e një sistemi të menaxhimit të korrespondencës dhe të qarkullimit të dokumenteve për ekipet e EULEX-it në ish gjykatat e qarkut. Në fillim kishte 31 gjyqtarë dhe 25 zyrtarë ligjorë të EULEX-it të vendosur së bashku me homologët e tyre vendorë në të gjitha gjykatat dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjyqtarët e EULEX-it dhe ata kosovarë punojnë përkrah njëri-tjetrit dhe i gjykojnë lëndët së bashku në kolegjet e përziera. Është arritur një shkallë e lartë e partneritetit me homologët vendorë. Përveç kësaj, janë vendosur marrëdhënie edhe me Odën e Avokatëve të Kosovës përmes një marrëveshjeje teknike që përcakton bashkëpunimin dhe bashkërendimin. Gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë funksionet e tyre gjyqësore në pajtim me Ligjin mbi kompetencat. Ligji mbi kompetencat u jep gjyqtarëve të EULEX-it kompetenca primare/ekskluzive dhe kompetenca sekondare/ subsidiare mbi një varg procedurash penale. Ky spektër i gjerë i veprave penale përshin në mes tjerash terrorizmin, gjenocidin, krimet kundër

---

<sup>51</sup> Ligji Nr. 03/L-053 (Ligji mbi kompetencat).



njerëzimit, krimet e luftës, krimin e organizuar, nxitjen e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar a etnik, vrasjen dhe vrasjen e rëndë, krimet ekonomike. Këto krime nga më të rëndat qofshin edhe në formë të tentativës dhe në forma të ndryshme të bashkëveprimit në kryerjen e krimit kanë qenë në kuadër të autorizimeve për hetime dhe për ndjekje penale të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) deri me 15 prill 2014 dhe në këtë mënyrë ishin nën kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it. Përveç kësaj, gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë kompetencat e tyre edhe në lëndët civile. Sipas nenit 5.1 të Ligjit mbi kompetencat, gjyqtarë civilë të EULEX-it kanë pasur të drejtën e përzgjedhjes dhe të marrjes së përgjegjësisë mbi lëndët civile në kuadër të kompetencave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me ish AKM-në tani AKP-në, mbi lëndët që bien brenda kompetencave të çdo gjykate të Kosovës përkitazi me ankesat ndaj vendimeve të Komisionit kosovar për kërkesa pronësore, dhe mbi çdo lëndë civile të re apo të pazgjidhur pronësore duke përfshirë procedurën e përmbarimit që bie brenda kompetencave të cilësdo gjykatë në Kosovë sipas kushteve të përcaktuara me nenin 5.1 (c) të Ligjit mbi kompetencat.

Në mes të datës 18 dhjetor 2008 dhe 31 mars 2009, gjyqtarët e EULEX-it kanë pranuar 185 lëndë penale nga UNMIK-u i cili i kishte përmbyllur aktivitetet gjyqësore. Këto lëndë ishin raste të ndërlikuara kriminale të cilat përfshijnë procedurat paraprake, hetimet, aktakuzat, gjykimet, ankesat, mjetet e jashtëzakonshme juridike, mjetet juridike dhe rigjykime<sup>52</sup>. Akuzat ishin nga më të ndryshmet duke filluar nga krime lufte kundër popullsisë civile dhe larje parash e deri tek krimi i organizuar dhe terrorizmi. Gjyqtarët e EULEX-it nga kjo trashëgimi e UNMIK-ut ndalën 120 lëndë. Pjesa tjetër e lëndëve penale, ku nuk kishte bazë për caktimin e kompetencës primare apo subsidiare të Gjyqtarëve të EULEX-it, kryesisht iu referuan për procedim të mëtejshëm sipas nevojës gjykatave kompetente kosovare ose iu dhanë prokurorëve të EULEX-it për shqyrtim të tyre.<sup>53</sup>

Gjatë vitit 2010 Këshilli Evropian i vuri në dukje rezultatet e arritura në promovimin e sundimit të ligjit nga EULEX-it në Kosovë në një ambient të vështirë të sistemit gjyqësor dhe sundimit të ligjit, duke përfshirë në ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve penale të ndjeshme

---

<sup>52</sup> EULEX-Raport vjetor mbi aktivitetet gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it.

<sup>53</sup> EULEX Komponenta e Gjyqësorit 20 Mars 2011. I Disponueshëm në: (<http://www.eulex-kosovo.eu/en/justice/>)

dhe të rëndësishme dhe misioni luajti rol të veçantë në forcimin e stabilitetit të rajonit në përputhje me perspektivën e saj evropiane.<sup>54</sup> Gjykatat në veri që u mbyllën në vitin 2008, ende nuk janë funksionalizuar plotësisht.<sup>55</sup> Marrëveshja e Brukselit për Drejtësinë që është një nga marrëveshjet më të rëndësishme të arritura në dialogun e Brukselit pasi që parasheh konsolidimin e sovranitetit shtetëror të Kosovës në fushën e drejtësisë në pjesën veriore të vendit. Marrëveshja për drejtësinë parasheh vendosjen e një sistemi unitar të drejtësisë në pjesën veriore të vendit, si dhe shuarjen e strukturave paralele serbe të drejtësisë në Kosovë. Gjithashtu, ajo mundëson që gjyqtarët dhe prokurorët serb të cilët më herët kanë punuar në këto struktura paralele të integrohen dhe të funksionojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës. Marrëveshja parasheh themelimin e një Gjykate Themelore dhe një Zyre të Prokurorisë në rajonin e Mitrovicës, në përputhje me ligjin e Kosovës, që do të mbulonin shtatë komuna si: Vushtrrinë, Skenderajn, Mitrovicën e Jugut, Mitrovicën e Veriut, Zveçanin, Leposaviqin dhe Zubin Potokun. Në përputhje me marrëveshjen e Brukselit, Kryetari i Gjykatës Themelore do të jetë nga minoriteti serb ndërsa zëvendëskryetari nga shumica shqiptare, ndërsa kryetari i Prokurorisë do të jetë nga shumica shqiptare, ndërsa zëvendëskryetari do të jetë nga minoriteti serb. Por ende kjo marrëveshje nuk është jetësuar për shkak të problemeve politike. Gjyqtarët e EULEX-it në Kosovë kanë për detyrë që të ndihmojë autoritetet gjyqësore për avancimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë etnik të drejtësisë, duke siguruar se këto institucione janë të lira nga ndërhyrjet politike dhe respektojnë standardet të cilat janë të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira evropiane.<sup>56</sup> Në vitin 2009 deri në shtator 2010, EULEX-i ka përfunduar pesë raste të krimeve të luftës, tetë prej tyre ishin në vazhdim dhe 27 në fazat e para të gjykimit. EULEX-i ka përfunduar tetë raste në lidhje me trazirat e marsit 2004, gjatë të njëjtës periudhë.<sup>57</sup> Ngjarjet e fundit në Kosovë, sidomos sulmet ndaj zyrtarëve në pjesën veriore të Kosovës bënë që EULEX të bëhet më aktiv dhe më i përfshirë në çështje të ndryshme.

---

<sup>54</sup> Vedran Džihic dhe Helmut Kramer: Kosova pas pavarësisë. A është duke i përmbushur premtimet e saj misioni i EULEX-it. I Disponueshëm në: (<http://library.fes.de/pdf-files/id/ipa/06571.pdf>)

<sup>55</sup> Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it, 01 Prill 2011. <http://www.eulexkosovo.eu/en/justice/assembly-of-the-eulex-judges.php>

<sup>56</sup> Po aty

<sup>57</sup> Po aty

Që nga viti 2008 gjyqtarët e EULEX-it kanë nxjerrë 620 aktgjykime, duke përfshirë 460 aktgjykime në rastet penale siç janë korrupsioni, krimi i organizuar, pastrimi i parave, krime lufte, trafikim me qenie njerëzore dhe 146 aktgjykime në lëndët civile. Këto aktgjykime kanë përfshirë ish gjyqtarë, zyrtarë policor, deputet, prokurorë dhe zyrtarë të lartë.

*Njësia e prokurorëve* të EULEX-it benë pjesë në Komponentin e Drejtësisë së EULEX-it. Objektivi kryesor është që të fuqizojë prokurorët e Kosovës për të kryer detyrat e tyre në përputhje me ligjin dhe sipas standardeve dhe praktikave më të mira evropiane. Autoriteti i dhënë prokurorëve të EULEX-it i lejon ata të veprojnë vetëm ose së bashku me prokurorët e Kosovës në pajtim me ligjin në fuqi, kompetencat e tyre ndryshojnë nga "monitorimi, mentorimi dhe këshillimi" kolegët e tyre vendorë për të ushtruar autoritet ekzekutiv (kryerjen e hetimeve penale për ndjekjen e re dhe rasteve në pritje). Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it janë të përcaktuara kryesisht në dy dokumente ligjore – në Ligjin mbi Kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, dhe në ligjin për Prokurorinë Speciale të Kosovës (PSRK). Prokurorëve të EULEX-it u është dhënë juridiksion në tërë Kosovën për një listë të veprave penale të përcaktuara në ligjet e përmendura më lart. Kompetencat ushtrohen në kuadër të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, PSRK-së, dhe të gjitha Prokurorive Themelore. Bashkëpunimi në mes të prokurorëve të Kosovës dhe EULEX-it në nivel rasti është i bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet prokurorëve të Kosovës dhe EULEX-it, e cila përfshin ndarjen e kompetencave, ngarkesën e punës dhe përgjegjësisë. Që nga fillimi i Misionit të EULEX-it në Kosovë në dhjetor të vitit 2008 dhe deri më datë (14 tetor 2010) numri i përgjithshëm i lëndëve të trajtuara nga prokurorët e EULEX-it ishte 1360, nga të cilat 1042 janë raste të reja dhe 321 janë dorëzuar nga UNMIK-u. Përveç kësaj, prokurorët e EULEX-it gjithashtu kanë trajtuar kërkesat e qytetarëve për çështje të prokurorisë. Ndër rastet më “spektakulare” ishte rasti i bastisjes në zyrat e Ministrisë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe banesën e ish ministrit Fatmir Limaj, akt i cili për një kohë i tensionoi marrëdhëniet ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe EULEX-it<sup>58</sup>. Shefi i Prokurorisë së Shtetit dhe në bashkëpunim më shefin e Agjencisë Anti-Korrupsion (AKK), kanë krijuar grupe të përbashkëta pune të cilat janë të përbëra nga prokurorë dhe zyrtarë të Agjencionit Anti-

---


<sup>58</sup> EULEX lufton korrupsionin në Kosovë: 10 Shkurt 2011

[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/blogrevieë/2010/05/21/blog-02](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/blogrevieë/2010/05/21/blog-02)

Korrupsion (AKK) me qëllim të identifikimit të mangësive dhe forcimit të bashkëpunimit të mëtejshëm.<sup>59</sup>

Misioni ka hetuar apo ngritur 250 aktakuza për krime lufte, pra dukshëm e ka zvogëluar numrin e lëndëve të krimeve të luftës në Kosovë. Përveç lëndëve të trashëguara, Misioni ka iniciuar hetimin e 98 rasteve të reja të krimeve të luftës. Që nga fillimi i misionit PSRK e EULEX-it ishte e përfshirë në faza të ndryshme të procedurës në 1.350 lëndë- 854 raste të pakryera (rastet e pakryera përfshijnë lëndët nga të gjitha kategoritë), 213 krime lufte, 16 të terrorizmit, 16 të krimeve financiare, 75 të korrupsionit, 143 të krimit të organizuar. Për momentin prokurorët në PRSK janë të përfshirë në 180 lëndë – 40 të krimeve të luftës, 6 krimeve financiare, 15 lëndë të korrupsionit, 40 lëndë të krimit të organizuar dhe 7 kundër terrorizmit.<sup>60</sup>

**Figura 5. Komponenta e drejtësisë**



<sup>59</sup> Po aty

<sup>60</sup> Një përmbledhje e RTK-së për punën e EULEX-it

## KAPITULLI III

### NDIKIMI I MISIONIT TE BASHKIMIT EVROPIAN DHE MBËSHTETJA E KOSOVËS NË PROCESET EURO-INTEGRUESE

#### 3. 1. Pozita e shteteve te Ballkanit perëndimor në proceset integruese

Duke pas parasysh se një ndër kriteret kryesore në integrimet euro atlantike është sundimi i rendit dhe ligjit atëherë kjo e fuqizon edhe me tepër rolin e Misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë - EULEX në ndihmën që po i jep institucioneve vendore në proceset integruese. Prezenca dhe përvoja e pjesëtarëve të EULEX-it është një aset shumë i çmuar të cilën pala Kosovare duhet ta shfrytëzoj në maksimum.

Zgjerimi i Bashkimit Evropian teoritikisht është i hapur për secilin vend evropian i cili është demokratik, por çdo vend i Ballkanit Perëndimor vlerësohet në bazë të meritave individuale. Bazuar në meritat individuale secili vend ka sfidat e veta në proces. Disa vende mund të kenë probleme në fushën e drejtësisë, tjerat në fushën e drejtave të njeriut dhe minoriteteve ndërsa disa të tjera në fushën ekonomike. Bazuar në rrugëtimin e shteteve drejt integritit evropian dhe vend ndodhjen e tyre në proces shtetet gjenden në nivele të ndryshme integruese. Fillimisht, në bazë të pozitës integruese shtetet e Ballkanit Perëndimor ndahen në dy kategori: shtetet kandidate dhe shtetet potenciale kandidate. Përderisa të gjitha shtetet e rajonit kanë avancuar pozitat e tyre në përafrimin e tyre drejt aderimit në Bashkimin Evropian, Kosova ka ngecur me mbrapa në këtë aspekt. Por jo vetëm me fajin e vet për mos kryerjen e detyrave të shtëpisë por edhe për shkak të mos unitetit të shteteve anëtare, duke pasur parasysh se 5 prej tyre ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Në prill të vitit 2016 ka hyrë në fuqi marrëveshja e stabilizim asociimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian<sup>61</sup>. Pas Sllovenisë, Kroacia bëhet shteti i dytë i ish federatës së Jugosllavisë që anëtarësohet në Bashkimin Evropian duke u

<sup>61</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/kosovo\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/kosovo_en).

bërë shteti i 28 anëtarë i unionit. Prej shteteve të rajonit, Maqedonia edhe pse e para ka nënshkruar marrëveshjen e stabilizim asociimit dhe ka aplikuar për statusin e vendit kandidat, ka stagnuar në avancimin e mëtutjeshëm drejt BE-së, që nga tetori i vitit 2009, Komisioni Evropian së fundmi e kushtëzoi me zbatimin e vazhdueshëm të Marrëveshjes së Przhinos dhe përparim të konsiderueshëm në zbatimin "Urgjent të Reformave Prioritare"<sup>62</sup>. Pra, Maqedonia ende është në pritje të datës për hapjen e negociatave për anëtarësim. Mali i Zi ka bërë një progres të madh në rrugën e integritimit në BE. Mali i Zi është në fazën e negociatave për anëtarësim që nga 29 qershori 2012.<sup>63</sup> Bosnja e Hercegovina përveç marrëveshjes për stabilizim e asociim që ka hyrë në fuqi më 01.06.2015, ka aplikuar edhe për statusin e kandidatit më 15.02.2016.<sup>64</sup> Por rruga e Bosnjës e Hercegovinës do të jetë e vështirë për shkak të mosmarrëveshjeve të mëdha brenda federatës. Si rezultat i këtyre mosmarrëveshjeve kemi bllokim të reformave të nevojshme që janë kusht për të lëvizur vendin drejt BE-së. Serbia pas bisedimeve me Kosovën ka përparuar në raportet e saj me BE-në, Serbia tashmë ka filluar negociatat për anëtarësim, së fundmi në shkurt të vitit 2017 Serbia ka hapur dy kapituj të ri.<sup>65</sup> Por e gjithë ecuria e mëtejshme e Serbisë do të varet nga raportet e saj me Kosovën si dhe respektimit të marrëveshjes së 19 Prillit për normalizimin e raporteve me Kosovën.

Një paraqitje grafike, duke përfshirë procesin integruar dhe pozitën e shteteve të Ballkanit Perëndimor brenda procesit të integritimeve evropiane. Shih tabelën si më poshtë.

---

<sup>62</sup>[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/former-yugoslav-republic-of-macedonia\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/former-yugoslav-republic-of-macedonia_en)

<sup>63</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/montenegro\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/montenegro_en)

<sup>64</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/bosnia-herzegovina\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/bosnia-herzegovina_en)

<sup>65</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/serbia\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/serbia_en)

**Tabela 1. Pozita e shteteve të Ballkanit Perëndimor brenda procesit të integrimeve evropiane.**

|  | Shteti                              | Statusi              | <a href="#">MSA</a>                   | Aplikimi për anëtarësim | Statusi i kandidatit | Fillimi i negociatave | Ekzaminimi i kompletuar | <a href="#">Kapitujt e acquis</a> te hapur/mbyllur |
|--|-------------------------------------|----------------------|---------------------------------------|-------------------------|----------------------|-----------------------|-------------------------|----------------------------------------------------|
|  | <a href="#">Shqipëria</a>           | Kandidate            | 2009-04-01<br>( <a href="#">MSA</a> ) | 2009-04-28              | 2014-06-24           | –                     | –                       | –                                                  |
|  | <a href="#">Bosna e Hercegovina</a> | Aplikuese            | 2015-06-01<br>(MSA)                   | 2016-02-15              | –                    | –                     | –                       | –                                                  |
|  | <a href="#">Kosova</a>              | Kandidate potenciale | 2016-04-01<br>(MSA)                   | –                       | –                    | –                     | –                       | –                                                  |
|  | <a href="#">Maqedonia</a>           | Kandidate            | 2004-04-01<br>(MSA)                   | 2004-03-22              | 2005-12-17           | –                     | –                       | –                                                  |
|  | <a href="#">Mali i Zi</a>           | Duke negociuar       | 2010-05-01<br>(MSA)                   | 2008-12-15              | 2010-12-17           | 2012-06-29            | 2013-06-27              | 2/26 nga 33                                        |
|  | <a href="#">Serbia</a>              | Duke negociuar       | 2013-09-01<br>(MSA)                   | 2009-12-22              | 2012-03-01           | 2014-01-21            | 2015-03-24              | 2/8 nga 34                                         |

Burimi: [https://en.wikipedia.org/wiki/Future\\_enlargement\\_of\\_the\\_European\\_Union](https://en.wikipedia.org/wiki/Future_enlargement_of_the_European_Union)

Kosova ende vazhdon të mbetet vendi më i izoluar në Evropë dhe qytetarët e saj mund të lëvizin drejt vendeve të Bashkimit Evropian vetëm pas kompletimit të shumë dokumenteve e pritjeve të gjata për marrje të vizës. Komisioni Evropian në fillim të muajt maj të vitit 2016 në një raport të tij, propozoi liberalizimin e vizave për Kosovën me kushtin e ratifikimit të marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi dhe rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Zyrtarisht kushti i vetëm sipas deklaratave të zyrtareve të BE-së mbetet ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi.

### 3. 2. Përfshirja e Kosovës në politikat integruese të BE-së

Pikërisht në vitin 1999 kur komuniteti ndërkombëtar ndërhyri në Kosovë, Bashkimi Evropian filloi të ri-aktualizojë politikën e vetme të Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA) për stabilizim dhe parapërgatitje të Ballkanit Perëndimor drejt integritit evropian. Politika e vetme e Bashkimit Evropian për Ballkanit Perëndimor mbetet PSA, e cila është një proces i ndihmës multi polare. Në vitin 2003, integrimi Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor u bë një realitet i prekshëm. Miratimi i Agjendës së Selanikut<sup>66</sup> për vendet e Ballkanit Perëndimor: Ecja drejt integritit evropian, si dhe paraqitja e instrumenteve të reja në mesin e të cilave edhe Partneritetet Evropiane, ishin elementet kryesore që materializuan perspektivën Evropiane për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Bashkimi Evropian tashmë kishte njohur statusin e vendeve potenciale kandidate në Feira.<sup>67</sup> Në mesin e instrumenteve më të rëndësishme mund të veçohet marrëveshja kontraktuale me BE-në dhe partneritetet evropian. Marrëveshja për Stabilizim Asociim mund të lidhet vetëm mes një shteti dhe Bashkimit Evropian, ndërsa në lidhje me Kosovën, në mungesë të statusit të padefinuar, marrëveshja kontraktuale nuk ka mundur të realizohet në fillim. Sa i përket Partneriteteve Evropiane nga Bashkimi Evropian, Kosova, në mënyrë të njëjtë sikurse shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor, shfrytëzon plotësisht Partneritetin Evropian, si një instrument të suksesshëm të parapërgatitjes drejt integritit evropian. Sipas AIE-së, Kosova gjendet plotësisht e përfshirë në procesin e integritimeve evropiane duke marrë për bazë instrumentet e përdorura si dialogu politik dhe teknik, mund të shfrytëzoj fondet e IPA-s, ka Partneritetin Evropian dhe kjo dëshmon përfshirjen e Kosovës plotësisht në proces, në prill të vitit 2016 ka hyrë në fuqi marrëveshja e stabilizim asociimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Nga viti 1999 deri para përcaktimit të statusit përfundimtar, Kosova, si një entitet i veçantë nën administrimin e Kombeve të Bashkuara, ka gëzuar një trajtim të veçantë në kuadër të politikave të PSA-së për Ballkanit Perëndimor. Bashkimi Evropian, duke ndihmuar Kosovën

---

<sup>66</sup> Shih Përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian 16 Qershor 2003 mbi Agjendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor: Ecja drejt integritit Evropian si dhe vendimet e takimit të Këshillit të Bashkimit Evropian më 19-20 Qershor 2003 në Selanik. [http://www.europarl.europa.eu/summits/pdf/the\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/summits/pdf/the_en.pdf)

<sup>67</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian i mbajtur më në vitin 2000 në Feira dhe e rikonfirmuar në Këshillin e Bashkimit Evropian më 24 Nëntor në Zagreb.



në forma të ndryshme të institucioneve të saj,<sup>68</sup> ka përfshirë Kosovën në proceset integruese ekonomike, ka ndihmuar në krijimin mekanizmave të veçantë për përfshirjen e Kosovës në proces dhe ka hapur perspektiven evropiane në shfrytëzimin e instrumenteve të politikës së BE-së për Ballkanit Perëndimor. Brenda një kornize të tillë, fillimisht në vitin 2002 Bashkimi Evropian krijoi Mekanizmin Përcjellës të Stabilizim Asocimit (MPSA), i cili u formua në mënyrë që Kosova dhe institucionet e saj, nën udhëheqjen e Kombeve të Bashkuara, të mos mbesin mbrapa në procesin e integritimeve evropiane. Gjatë kësaj periudhe, Kosova ishte kyçur në procesin e integritimeve në mënyrë jo të drejtpërdrejt përmes MPSA-së, ndërsa më vonë me instrumentin e Partneritetit Evropian të Bashkimit Evropian e cila është përdorur si formë shitesë e sinkronizimit të të gjitha përpjekjeve të mbështetjes, progresit dhe ndihmës financiare për Kosovën. Në anë tjetër, hapja e perspektivës evropiane<sup>69</sup> për Kosovën, shtyu qeverinë e Kosovës të ndërmarr hapat e parë të përgatitjes drejt integritimit evropian. Ndonëse gjatë periudhës së viteve 1999-2007, Kosova nën administrimin e Kombeve të Bashkuara ishte përballë një sfide të ndërtimit të institucioneve dhe maturisë shtet-formuese,<sup>70</sup> e cila më vonë rezultoi në krijimit e shtetit. Përfundimisht, Bashkimit Evropian ka përfshirë Kosovën brenda politikave të PSA-së respektivisht përmes instrumenteve të njëjta të përdorura sikurse për shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, e cila shtyu institucionet vendore qeveritare të bëjnë hapin e parë drejt sfidës së integritimit evropian.

---

<sup>68</sup> Përmes shtyllës së IV të MKBK-së, Agjencisë Evropiane për Rindërtim(AER), Zyrës ndërlidhëse të Komisionit Evropian dhe së fundi Zyrës Civile Ndërkombëtare si dhe misionit EULEX.

<sup>69</sup> Communication from the Commission, *A European Future for Kosovo*, Brussels 20th of April 2005, <http://www.euinkosovo.org/upload/Commission%20Communication%20%20European%20Future%20for%20Kosovo.pdf>

<sup>70</sup> Rrugëtimi i Kosovës dhe institucioneve të saj nën administrimin e Kombeve të Bashkuara ka pasur sfidat e ndërtimit të institucioneve, maturinë shtet-formuese nga institucionet e saj dhe në anën tjetër presionit politik brenda dhe jashtë saj lidhur me statusin e papërcaktuar.

### 3. 3. Raportet e progresit për Kosovën

Perspektiva e dhënë në Selanik u materializua në vitin 2004 përmes miratimit të rregullores për themelimin e Partneriteteve Evropiane, e cila formalisht për herë të parë përfshiu Kosovën në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor.<sup>71</sup> Rrjedhimisht, Komisioni Evropian, në mesin e Partneriteteve Evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor, përgatiti dhe paraqiti partneritetin e veçantë Evropian për Kosovën.<sup>72</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi për herë të parë në Qershor të vitin 2004 Partneritet Evropian si me shtetet e Ballkanit Perëndimor ashtu edhe me Kosovën ndërsa të njëjtat i rishqyrtoi në Janar të vitit 2006. Në lidhje me Kosovën, Komision Evropian në pjesën e parë të vitit 2005 kishte paraqitur një objektivë të qartë për perspektivën afatgjatë të saj drejt integritit evropian dhe kishte vlerësuar se ndonëse Kosova me status të papërcaktuar përfundimtar, nën administrim të Kombeve të Bashkuara, do të duhej të tejkalonte izolimin dhe të marr pjesë në procesin e integritit evropian në rajon për të mos mbetur mbrapa vendeve të Ballkanit Perëndimor.<sup>73</sup> Brenda përmbajtjes së Partneritetit Evropian për Kosovën, Bashkimi Evropian kishte përgatitur prioritet afatshkurta dhe afatmesme mbi bazën e të cilit qeveria e Kosovës është përgjigjur në hartimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian(PVPE). Të gjitha instrumentet shtesë të BE-së në Kosovë duke përfshirë Partneriteti Evropian dhe raportet vjetore të progresit, kishin plotësuar mekanizmin e deriatëhershëm të MPSA për marrëdhënie të Kosovës me Komisioni Evropian dhe kishin stimuluar institucionet qeveritare vendore për një dedikim konkret drejt rrugës dhe perspektivës afatgjatë evropiane për Kosovën. Në përgjithësi integritet kërkojnë harmonizim dhe standardizim të funksionimit të

---

<sup>71</sup> Kosovo, as defined under Security Council resolution 1244: see the EC regulation No 533/2004, Brussels, 22<sup>nd</sup> of March 2004, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:086:0001:0002:EN:PDF>

<sup>72</sup> Shih vendimin e Këshillit për miratimin e para të Partneriteteve Evropiane: Vendimi i Këshillit Nr. 520/2004, Bruksel, 14 Qershor 2004, si dhe rishqyrtimin e Partneritetit Evropian: Vendimi i Këshillit Nr. 56/2006 shqyrtimi i vendimit, Bruksel, 30 Janar 2006, në kuadër të cilave Kosova është e përcaktuar si entitet nën administrimin e rezolutës 1244 më 10 Qershor 1999 dhe gëzon të drejtën e partneritetit të veçantë.

<sup>73</sup> Communication from the Commission, *A European Future for Kosovo*, Brussels 20th of April 2005, <http://www.euinkosovo.org/upload/Commission%20Communication%20%20European%20Future%20for%20Kosovo.pdf>

institucioneve të një vendi dhe ngritje të standardit jetësor në mënyrë që të mos kemi çrregullim të sistemit juridik, politik dhe ekonomik të bashkësisë në një vend që synon të integrohet.

BE-ja ka instaluar mekanizma të shumtë: në vlerësimin e stabilitetit institucional, sundimin e ligjit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, zhvillimit ekonomik, mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe historike, zhvillimin e aktiviteteve rinore dhe krijimin e kushteve për investime të huaja. Komisioni Evropian për të gjitha shtetet kandidate dhe kandidatët potencial ka paraparë të harton raporte të cilat njihen me emrin si Raportet e Progresit dhe që kanë për qëllimi primar të vlerësojë të arriturat dhe ngecjet që shtetet kandidate dhe shtetet kandidate potenciale janë afër apo larg integritit në institucionet e Bashkimit Evropian.

Raporti vjetor i Komisionit Evropian është një instrument tjetër kontrolli dhe njëkohësisht përmbledhës i ecuresë se reformave të ndërmarra nga vendet që synojnë anëtarësimin në BE, përfshirë edhe Kosovën. Ai përcaktohet si i tillë edhe në nenin 6 të Partneritetit Evropian i cili parashikon se zbatimi i prioritetëve që përmbahen në këtë dokument monitorohet nga Raporti Vjetor i Komisionit Evropian. Ai përgatitet dhe publikohet çdo vit nga komisioni evropian dhe trajton në mënyrë të hollësishme gjendjen e vendit në të gjitha aspektet politike, institucionale, ligjore dhe ekonomike si dhe sugjeron çështjet në të cilat duhet të përqendrohet vëmendja dhe përmirësimi gjatë 12 muajve të ardhshëm. Raporti ruan të njëjtën strukturë dhe metodologji çdo vit dhe për të gjitha vendet e përfshira në PSA, duke u ndalur në analizimin e reformave të ndërmarra nga shtetet e asociuara me qëllim përmbushjen e kushteve dhe kritereve politike, ekonomike dhe arritjen e kapacitetit për përafrimin e legjislacionit në kuadër të *acquis communautaire*.

Nga marsi i vitit 2002, Komisioni Evropian ka hartuar dhe ka referuar rregullisht pranë Këshillit dhe Parlamentit Evropian progresin e bërë nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Progresraporti ka këto karakteristika:

- është një raport që përgatitet çdo vit;
- është individual për çdo shtet të përfshirë në procesin e Stabilizim-Asociimit dhe bazohet në arritjet dhe sfidat e secilit vend.
- nga pikëpamja formale progresraporti ka të njëjtën strukturë të jashtme për secilin vend.

Ai përmban një përshkrim të shkurtër mbi marrëdhëniet e shtetit të asociuar dhe BE-së, me pas analizohet kriteri politik i integritit, kriteri ekonomik si dhe vlerësohen kapacitetet për implementimin e *acquis communautaire* nga shteti i asociuar.

Nga një analizë e shkurtër e progresraporteve të fundit të Komisionit Evropian rezulton se aty theksohet mungesa e kapaciteteve dhe pavarësisë së administratës publike dhe sistemit gjyqësor. Gjithashtu duhen konsoliduar shteti i së drejtës, politikat anti-korrupsion, lufta kundër krimit të organizuar etj. Ekonomia e Kosovës ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm për ndërtimin e një ekonomie tregu funksionale, papunësia dhe inflacioni mbetën faktorë që ndikojnë në makroekonominë kosovare. Kosova është në proces të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së në fusha si doganat, energjia, punësimi, korrupsioni dhe krimi i organizuar. Ndërsa në raportin e fundit, atë të vitit 2016 theksohet se ky vit shënon një epokë të re të marrëdhënieve mes Kosovës dhe BE-së me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes të Stabilizim Asociimit. Si marrëdhënia e parë kontraktuale në mes të BE-së dhe Kosovës paraqet një moment të rëndësishëm për Kosovën dhe për rrugën e saj drejt të ardhmes evropiane. Ajo përfshin të drejta dhe obligime të ndërsjella dhe mbulon një shumëllojshmëri të madhe të sektorëve. MSA-ja përqëndrohet në respektimin e parimeve kryesore demokratike dhe elementeve kryesore që janë në zemër të tregut të vetëm të BE-së. Kosova tani duhet të fokusohet në implementimin e MSA-së, e udhëhequr nga Agjenda e Reformave Evropiane të cilën Komisionari Hahn e lansoi së bashku me kryeministrin e Kosovës.

Ky ka qenë një vit sfidues për Kosovën, i penguar nga polarizimi politik në mes të qeverisë dhe opozitës dhe nga tensioni i rritur në mes të partnerëve të koalicionit. Këto sfida të brendshme kanë penguar reformat që lidhen me BE-në në disa fusha. Të gjithë akterët politikë duhet të punojnë drejt gjetjes së një rruge për t'i dhënë fund ngërçit të tej zgjatur, t'i kthehen debatit politik në parlament dhe të fokusohen në reforma vitale për qytetarët. Kosova dhe Serbia kanë bërë progres në normalizimin e marrëdhënieve, edhe pse ai mbetet i kufizuar. Është e rëndësishme që Prishtina dhe Beogradi të mbeten të angazhuar drejt procesit, duke përfshirë zbatimin e marrëveshjeve.

Përkundër që ka qenë vit sfidues, janë bërë disa reforma dhe përpjekje pozitive. Aty përgëzohen institucionet e sundimit të ligjit të Kosovës për punën që kanë bërë në bërjen e reformave të gjera, duke ia mundur në këtë mënyrë Komisionit Evropian të propozojë liberalizimin e vizave për Kosovën. Tani i mbetet Kuvendit dhe institucioneve të sundimit të ligjit të Kosovës të përmbushin dy kriteret e mbetura dhe pastaj Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së, të vendosin.

Kosova tashmë ka bërë hapat e parë të dukshëm për mbajtjen e të dhënave mbi korrupsionin e nivelit të lartë dhe për hetimet e krimit të organizuar. Ky është rezultat i progresit të mirë gjatë vitit të fundit të vënë në dukje nga fushat e sundimit të ligjit të arritur nga përforcimi i ligjit dhe institucionet gjyqësore. Raporti posaçërisht lavdëron Kosovën në luftën kundër korrupsionit për themelimin e ekipeve multi disiplinare nën zyrën e Prokurorit Special dhe futjen e një mekanizmi ndaj korrupsionit të nivelit të lartë dhe rastet e krimit të organizuar. Kjo vjen si rezultat i kushtëzimit të BE-së në bazë të udhërrëfyesit të vizave. Megjithatë, korrupsioni mbetet i përhapur në Kosovë dhe vullneti më i fortë politik për të trajtuar këtë mbetet i nevojshëm.

Mbi reformën e administratës publike raporti vë në dukje përparimin e mirë të arritur me miratimin e një sistemi gjithëpërfshirës të menaxhimit financiar publik dhe miratimin e ligjit për procedurat e përgjithshme administrative. Duhet një përpjekje më e madhe - duke përfshirë angazhimin politik të fortë e të vazhdueshëm të nivelit të lartë - është e nevojshme për të kapërcyer fragmentimin, llogaridhënien e kufizuar dhe shkeljen e përgjegjësisë të agjencive dhe organeve - që mbeten në rrezik të politizimit. BE ka shprehur gatishmërinë që të ndihmojë Kosovën në këtë drejtim në të ardhmen, ku parashikohen reforma të konsiderueshme dhe të rëndësishme mbi shërbimin civil, organizimin e administratës publike dhe pagat publike.

Emërimet në institucionet e pavarura dhe organet rregullative mbeten të cënueshme ndaj ndërhyrjeve të paligjshme dhe reformave të rëndësishme dhe angazhimi mbetet i nevojshëm për të siguruar që ato janë bërë në mënyrë transparente dhe janë të bazuara në merita. Është bërë progres në fushën e prokurimit publik, veçanërisht për sa i përket shtrirjes së mëtejshme të legjislacionit, hapave të mirë të parë drejt prokurimit elektronik dhe zgjerimit të prokurimit të centralizuar, si dhe eliminimin e trajtimit preferencial për ofertuesit e brendshme.

Në raport theksohet se ka një ndryshim të vogël pozitiv në ekonomi dhe konkurrencë. Situata fiskale është përmirësuar, por ende ekzistojnë shqetësime rreth vendimit fiskal të paqëndrueshëm për përfitimet e veteranëve të luftës. Në përgjithësi, është bërë pak progres. Disa përparime janë bërë në mbështetjen e bizneseve të orientuara nga eksporti, qasjen në financa, zbatimin e përforcuar të kontratave.

Por, në përgjithësi deficiti i vazhdueshëm tregtar reflekton një bazë të dobët të prodhimit dhe varësinë nga remitencat. Kosova mbetet gjerësisht jo konkurruese ndërkombëtarisht, dhe për

fat të keq nuk vihet re përparim në përmirësimin e cilësisë së arsimit, i cila është një udhëheqës kyç i konkurrencës afatgjate dhe rritjes ekonomike.

Këtu situata nuk ka ndryshuar shumë nga vitet e kaluara. Reformat strukturore ekonomike mbeten të nevojshme për të adresuar sfidat kryesore ekonomike të papunësisë së lartë, mospërputhjes në mes të arsimit dhe tregut të punës, në mënyrë që të luftohet informaliteti.

Këto janë disa nga çështjet kryesore nga raporti i këtij viti që theksohen në këtë raport. Është e qartë se Kosova mbetet në një fazë të hershme të përgatitjes për të marrë obligimet e anëtarësimit. Raporti i Kosovës thekson arritjet kryesore dhe sfidat që duhet urgjentisht të trajtohen. Është e qartë se duhet shumë punë për të kapërcyer mangësitë e rëndësishme në qoftë se Kosova do të bëjë përparim në rrugën e saj evropiane.

### **3. 4. Marrëveshja për procesin e stabilizim asociimit**

Procesi i Stabilizim-Asociimit (SAP), i miratuar dhe vënë në fuqi më 1999, është korniza e politikave të Bashkimit Europian për Ballkanin Perëndimor, në kuadër të së cilës zhvillohet procesi i integritit të këtyre shteteve në BE deri në anëtarësimin e tyre të plotë. Ky proces ka tri qëllime strategjike:

- stabilizimin dhe tranzicionin drejt një ekonomie të lirë dhe konkurrencte te tregut;
- promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe;
- perspektivën Europiane

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është proces i dyanshëm dhe proces rajonal, me të cilin krijohen marrëdhëniet ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore dhe të BE-së dhe, në të njëjtën kohë, nxitet bashkëpunimi ndërmjet vendeve të rajonit. Përmes këtij procesi BE i ndihmon dhe i shërben si udhërrëfyes secilit vend në procesin e zhvillimit të tyre, në mënyrë që kur të bëhen anëtarë të plotë të jenë në gjendje të vënë në jetë standardet europiane, duke i mundësuar secilit që të jetë në gjendje të luajë rolin e tij si anëtar me të drejtat dhe obligime të plota.

Në kuadër të negociatave të PSA-së, BE u ofron këtyre vendeve lehtësira tregtare, ndihma ekonomike, teknike e financiare, dhe marrëdhënie kontraktuale. Në kuadër të këtij procesi, përgatitja e secilit vend për anëtarësim matet duke u bazuar në përmbushjen e

obligimeve të vendosura në kuadër të ‘kriterëve të Kopenhagës’ (1993) dhe atyre të Madridit (1995).

Kriteret që duhet t’i plotësojë secili vend janë si në vijim: institucione stabile të cilat garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, dhe respektimin e mbrojtjen e minoriteteve (kriteret politike). Një ekonomi funksionale të tregut, e cila të jetë në gjendje të përballët me presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut brenda tregut të BE-së (kriteret ekonomike). Kapacitetet për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, në përputhje të veçantë për objektivat e bashkimit politik, ekonomik dhe monetar. Kjo në veçanti kërkon që secili vend të ketë krijuar kushtet për integrimin e tij nëpërmjet zhvillimit të strukturave të tij administrative dhe gjyqësore deri në atë nivel sa ato të sigurojnë jo vetëm integrimin e Acquis-së në legjislacionin kombëtar, por, çka është më e rëndësishmja, vënien e tij në zbatim në mënyrë efektive (standartet evropiane).

Përparimi i secilit vend drejt përmbushjes së këtyre kriterëve monitorohet rregullisht dhe prezantohet në Raportet vjetore të Progresit për secilin vend, të cilat vlerësojnë se sa janë të gatshme ato të afrohen me BE-në. Instrumentet e tij janë formuluar në Samitin e Zagrebit (2000), dhe janë avancuar më tej në Samitin e Selanikut (2003), i cili futi në veprim një varg instrumentesh të reja për të mbështetur procesin e reformave në vendet e Ballkanit Perëndimor për t’i dërguar ato më shpejt drejt BE-së. Instrumenti kryesor i PSA-së janë Partneritetet Evropiane, të cilat BE ia ofron secilit vend të Ballkanit Perëndimor që nga viti 2004, dhe ku identifikohen prioritetet afatshkurta dhe afatmesme që duhet përmbushur me qëllim të implementimit të reformave dhe të përgatitjes së tyre për anëtarësim në BE.

Procesi i Stabilizim Asociimit(PSA) si politikë kryesore e BE-së drejt Ballkanit Perëndimor përfshinë marrëveshjet kontraktuale formale që Bashkimi Evropian lidh me çdo shtet në bazë të meritës individuale. Rasti i veçantë i statusit politik të Kosovës, në mungesë të statusit përfundimtar, ka pamundësuar një përfshirje të drejtpërdrejt në PSA, ndërsa Komisioni Evropian nuk ka mundur të fillojë një raport fizibiliteti me Kosovën.<sup>74</sup> Në të njëjtën kohë, procesi i integritimeve evropiane kishte përfshirë të gjithë fqinjët e saj që ishin në hapa të ndryshëm, ndërsa në mënyrë që Kosova të mos mbetet mbrapa vendeve në rajon, Komisioni Evropian krijoi mekanizmin e veçantë për rastin e Kosovës, Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim

---

<sup>74</sup> Renzo Daviddi, Kryesues i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, *Intervistë*, Prishtinë më 28 Shtator 2007

Asociimit(MPSA),<sup>75</sup> si një kornizë e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian. MPSA për Kosovën krijoi një mundësi të mirë për të ndihmuar dhe përgatitur Kosovën dhe institucionet e saj drejt integritit evropian. Praktikisht ky forum diskutimesh, nga viti 2002, ka funksionuar në dy nivele. Niveli i takimeve më të larta mes autoriteteve Kosovare të MKBK-së dhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ) si dhe përfaqësuesve të delegacionit të Komisionit Evropian në Prishtinë. Ndërsa takimet e nivelit të dytë, takimet ministrore sektoriale, të cilat së bashku formuan një forum diskutimesh i cili ka shërbyer si një lloj dialogu politik dhe ekonomik si dhe një forum të të kuptuarit të procesit nga IPVQ-të, identifikimin e sfidave dhe adresimit të tyre në proces. Në aspektin institucional të udhëheqjes së takimeve, fillimisht ky forum kryesohej nga përfaqësues të MKBK-së, ndërsa me fuqizimin e vazhdueshëm të institucioneve të Kosovës, duke filluar nga takimi i nëntë, ky forum filloi të bashkë-kryesohej nga Qeveria e Kosovës, respektivisht nga kryeministri i Kosovës. Temat e diskutimeve në të gjitha nivelet e këtyre forumeve buronin nga vendimet respektive të Bashkimit Evropian për rajonin dhe Kosovën. Temë diskutimesh në këtë forum ishin bërë gjithashtu paraqitja e perspektivës evropiane për Kosovën,<sup>76</sup> si dhe gjithashtu, paraqitja e Partneritetit Evropian për Kosovën,<sup>77</sup> por gjithashtu edhe diskutimet rreth raportit vjetor të progresit i lëshuar nga Komisioni Evropian. Duke parë trendet integruese në rajon, në përputhje të plotë me politikat e Bashkimit Evropian, Qeveria e Kosovës intensifikoi përpjekjet dhe angazhimet<sup>78</sup> në hartimin dhe miratimin e Planit të Veprimit dhe zbatimit të tij. Deri në fund të vitit 2007 janë mbajtur gjithsej 12 takime të nivelit të lartë të MPSA-së<sup>79</sup> dhe një numër takimesh sektoriale.<sup>80</sup>

---

<sup>75</sup> Bashkimi Evropian krijoi Mekanizmi Përcjellës për Stabilizim Asocim (MPSA) për rastin e Kosovës më 06 Nëntor 2002.

<sup>76</sup> Communication from the Commission, *A European Future for Kosovo*, Brussels 20th of April 2005, <http://www.euinkosovo.org/upload/Commission%20Communication%20-%20European%20Future%20for%20Kosovo.pdf>

<sup>77</sup> Council Decision, *on the establishment of European Partnerships with Kosovo* as defined under resolution 1244, Brussels, 30 of January 2006, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:035:0032:0056:EN:PDF>

<sup>78</sup> Agjenda Evropiane e Qeverisë së Kosovës, Janar-dhjetor 2006

<sup>79</sup> Shih 12 Takimet e Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim Asocimit dhe temat e trajtuara brenda këtyre takimeve të nivelit të lartë mes autoriteteve Kosovare të MKBK-së, IPVQ-ve dhe delegacionit të Komisionit Evropian në Kosovë.



Përkushtimi i Qeverisë së Kosovës ishte mjaft evident sidomos drejt zbatimit të prioritetëve të Planit Veprues të Partneritetit Evropian (PVPE), megjithatë, duke filluar nga vitit 2007, agjenda e statusit përfundimtar të Kosovës dhe periudha para dhe pas pavarësimit të Kosovës, larguan agjendën evropiane dhe ndikuan në ngadalësimin angazhimeve të qeverisë së Kosovës në procesin e integriteteve evropiane.<sup>80</sup> Pas kryerjes së Studimit të Fizibilitetit për Kosovën (gjatë tërë vitit 2009), në nëntor 2009 KE ka publikuar Komunikatën Kosova – Përmbushja e Perspektivës Evropiane”, në bazë të së cilës Procesi i Stabilizim-Asociimit për Kosovën është avancuar nga Mekanizmi Përcjellës i Stabilizim-Asociimit (MPSA) në Dialogun e Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA). Korniza e DPSA-së ka filluar së zbatuari në fillim të vitit 2010.

Në tetor të vitit 2011, Komisioni Evropian pati publikuar studimin e fizibilitetit në kontekst të hapjes së negociatave për MSA. Qëllimi i së cilës është ofrimi i kornizës politike dhe ligjore që do të rregullonte procesin e përafrimit dhe anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Ishin katër kritere të vena nga Komisioni Evropian: ai në fushën e reformës së administratës publike, në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, në fushën e mbrojtjes të të drejtave të komuniteteve dhe në fushën e tregtisë. Në këtë drejtim, me 27 shkurt, Qeveria e Republikës së Kosovës themeloi ekipin negociator që udhëhiqej nga Ministria e Integritetit Evropian të organizuar në 3 grupe punuese, e që ishin; grupi punues për çështje tregtare; grupi punues për përafrim të legjislacionit si dhe grupi punues për politikën e bashkëpunimit. Negociatat filluan të zhvillohen sipas kapitujve negociues dhe fillimisht u negociuan çështjet e lirisë së mallrave, pastaj harmonizimit të legjislacionit dhe në fund u negociuan politikën e bashkëpunimit.

Procesi i nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), ka filluar atëherë kur Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së kishte miratuar propozimin e Komisionit për fillimin e negociatave më 12 dhjetor 2012. Bazuar në këtë raport, më 28 qershor 2013, Këshilli i BE-së mori vendimin për nisjen e negociatave për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Negociatat filluan më 28 tetor 2013, me takimin e parë të kryenegociatorëve. Pas hapjes së

---

<sup>80</sup> Vetëm gjatë vitit 2007, gjithsej gjashtë takime të rregullta sektoriale janë mbajtur në fushën e mjedisit, infrastrukturës, qeverisjes së mirë, tregut të brendshëm, energjisë dhe ekonomisë.

<sup>81</sup> Që nga takimi i parë më 13 Dhjetor 2003 e deri në takimin e fundit 19 Mars 2007 janë mbajtur gjithsej 12-të takime të larta të MPSA-së. Gjatë vitit 2007 është mbajtur vetëm një takim i nivelit të lartë, duke pasur parasysh fokusin e qeverisë së Kosovës në zgjidhjen përfundimtare të statusit politik të saj.

negociatave, me fokus në kapitujt IV, V dhe VI, raundi i dytë i tyre, i mbajtur më 27 Nëntor 2013, u fokusua në përmbylljen e këtyre tre kapitujve, me ç'rast gjithashtu u hapën negociatat për kapitujt I, III, VII, VIII, IX dhe X. Raundi i tretë dhe i katërt u zhvilluan në dhjetor 2013, respektivisht në shkurt 2014, kurse në raundin e pestë (më 24 mars 2014) u fokusua në kapitullin e fundit të mbetur, Kapitullin II, mbi dialogun politik. Pas pesë raundesh të negociatave, takimi përfundimtar i kryenegociatorëve u mbajt më 2 maj 2014, në Prishtinë, me ç'rast MSA ishte miratuar prej tyre, me vendosjen e inicialeve në korrik 2014.

Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit më 27 tetor 2015, në Strasburg. Ajo më pas u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30 tetor 2015, përmes Vendimit nr. 01/55 për miratimin e Projektligjit për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, dhe u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 nëntor 2015, me miratimin e Ligjit nr. 05/L-069 për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër<sup>82</sup>.

MSA vendosë kornizën e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së për jetësimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) deri në anëtarësimin e plotë në BE. Sa i përket fushëveprimit, përveç çështjeve politike e detyrimeve juridike (përfshirë ato që prekin rendin e brendshëm juridik), MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes. Ajo përmban dhjetë 'tituj' (kapituj kryesorë, ose krerë), si dhe shtatë shtojca, pesë protokolle dhe një deklaratë të përbashkët:

- Kreu I: Parimet e përgjithshme;
- Kreu II: Dialogu politik;
- Kreu III: Bashkëpunimi rajonal;
- Kreu IV: Lëvizja e lirë e mallrave;
- Kreu V: Themelimi, ofrimi i shërbimeve dhe kapitali;
- Kreu VI: Përafrimi i ligjeve të Kosovës me *acquis*, zbatimi i ligjit dhe rregullat e konkurrencës;
- Kreu VII: Liria, siguria dhe drejtësia;

---

<sup>82</sup> <http://www.mei-ks.net/sq/procesi-i-stabilizim-asociimit>

- Kreu VIII: Politika e bashkëpunimit;
- Kreu IX: Bashkëpunimi financiar; dhe
- Kreu X: Dispozitat institucionale, të përgjithshme dhe ato përfundimtare.

Pjesa dërmuese e MSA-së bazohet në acquis-n e BE-së, përkatësisht tërësinë e normave juridike të zbatueshme brenda territorit të saj dhe nga të gjitha shtetet anëtare si subjekte juridike, dhe mbulon të gjitha fushat e politikave. Prandaj, Kosova, si shtet që synon anëtarësimin në BE, duhet që gjatë procesit deri te anëtarësimi të miratojnë tërë acquis-në dhe ta bëjë atë pjesë të legjislacionit të saj të brendshëm. Sipas MSA-së, gjatë vitit 2016, do të krijohen struktura të përbashkëta Kosovë – BE për procesin e stabilizim asociimit të cilat do të marrin vendime politike dhe vendime tjera për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e MSA-së. Këto struktura që pritet të themelohen janë:

- Këshilli për Stabilizim Asociim (Niveli më i lartë politik);
- Komiteti për Stabilizim Asociim;
- Nën-komitetet për Stabilizim Asociim;
- Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asociim (strukturë e përbashkët mes Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Kosovës).

Fokusi tani duhet të jetë në ndërtimin e në zbatimin e tij. BE-ja ka shprehur gatishmërinë për të ndihmuar këtë politikisht dhe financiarisht, dhe janë të gatshëm të punojmë me Kosovën, veçanërisht në drejtim të Agjendës së Reformave Evropiane<sup>83</sup>. Agjenda është e bazuar në tri shtylla të gjera:

- Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë;
- Konkurrenca dhe Investimet, dhe;
- Punësimi dhe Edukimi.

Prioritetet e saj, dhe veprimet që qeveria angazhohet të ndërmarrë për të përmbushur ato, kanë për qëllim adresimin e "pengesave" kyçe për rritjen ekonomike. Si e tillë, kjo agjendë do të jetë një mjet i rëndësishëm për zbatimin e MSA-së që synon kapjen e mundësive që MSA ofron si mjet kryesor për avancimin e agjendës e BE-së për Kosovën. Qëllimi i tij është përqendrimi i

---

<sup>83</sup> <https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo>

vëmendjes për reformat kyçe që do të ndihmojë në fillimin e zbatimit gjatë 12 deri 18 muajt e ardhshëm

## PËRFUNDIM

Në këtë punim është analizuar roli i misionit të BE-së, EULEX, në fushën e sundimit të ligjit në përkrahjen e institucioneve vendore të Kosovës, dhe gjithashtu është analizuar edhe ndikimi i tij në përafrimin e Kosovës drejt BE-së. Me anë të këtij hulumtimi përmes metodave si metoda analitike, e intervistimit, krahasuese dhe deskriptive/historike është paraqitur rrugëtimi i Kosovës drejt konsolidimit të subjektivizmit të vet si shtet i pavarur dhe sovran dhe orientimi i saj properëndimorë dhe ndihmën e BE-së përmes mekanizmave të saj në Kosovë në forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit.

Bashkimi Evropian është bërë faktori kyç i stabilitetit politik dhe ekonomik si për Kosovën ashtu edhe për tërë Ballkanin Perëndimor. Bashkimi Evropian mbetet një ndër mbështetësit kryesor të Kosovës si në zhvillimin ekonomik ashtu e veçmas në atë të sundimit të ligjit përmes misionit të saj EULEX. Bashkimi Evropian qysh në ditët e para e ka quajtur Kosovën si një rast i veçantë historik dhe politik i cili nuk shënon precedent për vendet e tjera. Që nga intervenimi i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë, Bashkimi Evropian përfshiu Kosovën si rast të veçantë brenda procesit të integritimeve evropiane në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Bashkimi Evropian ka qenë pjesë integrale e përpjekjeve ndërkombëtare për ndërtimin e një të ardhmeje të re për Kosovën që nga viti 1999. Shtetet anëtare dhe institucionet e tij, veçanërisht misioni i BE-së, EULEX, luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e sundimit të rendit dhe ligjit në Kosovë. Bashkimi Evropian ishte i përkushtuar për të ofruar paqe, siguri, stabilitet dhe perspektivë evropiane për Kosovën gjatë statusit të saj përfundimtar dhe tërë rajonin në bazë të të cilës kishte bërë përgatitjet paraprake për të udhëhequr me prezencën ndërkombëtare në Kosovë pas statusit përfundimtar të saj. EULEX në Kosovë, bazuar në politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes evropiane u themelua për të ndihmuar dhe avancuar autoritetet kosovare në ngritjen e kapaciteteve gjyqësore, policore dhe zhvillimin e doganave.

Me qëllim që të arrihen objektivat e këtij hulumtimi është bërë analiza e gjendjes faktike në terren dhe të rezultateve të arritura. Rezultatet e nxjerra nga ky hulumtim tregojnë se ka pasur progres të institucioneve të rendit dhe ligjit. Kosova vitin e kaluar ka bërë një hap përpara drejt BE-së duke e nënshkruar marrëveshjen e stabilizim asociimit, ku padyshim edhe EULEX-i ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. EULEX ka pasur një rol shumë aktiv edhe në veri të Kosovës kur për një kohë nuk ka qenë i mundur funksionimi i institucioneve vendore. Misioni i EULEX-it ofron mbështetje për dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës përmes ofrimit të asistencës për zbatimin e marrëveshjeve të mbetura të dialogut në sferën e sundimit të ligjit. Përkundër kësaj gjendja e sigurisë në veri të Kosovës mbetet e brishtë si rezultat i tensioneve politike, edhe pse është arritur marrëveshja për funksionalizimin e gjykatave dhe prokurorisë në veri, kjo ende nuk ka ndodhur.

Prezenca e Bashkimit Evropian në Kosovë e në veçanti misionit të EULEX-it kanë ndihmuar Kosovën në konsolidimin e shtetit ligjor, sundim të ligjit në përputhje të plotë me standardet evropiane dhe janë një faktor i rëndësishëm në rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

EULEX-i gjithashtu ka hetuar dhe gjykuar rastet e "profilit të lartë", ku të tillë konsiderohen një grup i njerëzve që kanë një ndikim të madh në jetën publike e politike ose që kanë lidhje me partitë me të mëdha politike dhe bizneset. Shumë nga këto raste do të ishin të pa përfytyrueshme që të trajtohen nga personeli gjyqësor vendor. Në shumë raste ka arritur që të parandaloj presionin politik të ushtruar mbi institucionet gjyqësore dhe institucionet të tjera të pavarura, duke sfiduar mosndëshkimin vendor. Kjo ka ndodhur vetëm kur dhe ku personeli i misionit kanë qenë të pranishëm. Prania e EULEX-it në disa nga institucionet e Kosovës ka pasur një ndikim të rëndësishëm në mbrojtjen e pavarësisë së institucioneve.

Të gjitha kompetencat ekzekutive të EULEX-it tanimë kanë filluar të zvogëlohen me ristrukturimin e fundit të Misionit, shumica e lëndëve u janë dorëzuar gjyqtarëve dhe prokurorëve vendor. Marrja përsipër e suksesshme dhe mbyllja e këtyre rasteve, e monitoruar nga zyra e BE-së, duhet të përdoret si tregues për të matur progresin e vendorëve në fushën e gjerë të sundimit të ligjit. Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, të cilët janë të përfshirë me fuqitë e tyre ekzekutive duhet të zhvendosen në ofrimin e trajnimeve rigoroze profesionale mbi

praktikat me te mira evropiane për gjyqtaret dhe prokuroret e Kosovës. Bashkimi Evropian do të duhej të ndikoj më shumë në vendet anëtare të saj në njohjen sa më të shpejt të pavarësisë së Kosovës nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, e cila do të dëshmoj unifikimin e qëndrimit të BE-së rreth Kosovës dhe do t'i hapte rrugën Kosovës për hapat e mëtejshëm drejt integritetit të Kosovës në BE.

Në kuadër të mundësive të dhëna drejt avancimit të nivelit aktual, sikurse vendet tjera të rajonit, gjatë pranimi dhe zbatimit rekomandimeve të BE-së për të ndërmarrë reformat e nevojshme, Kosova duhet të shfrytëzoj këtë asistencë që ofron pikërisht ky mision.

Bashkimi Evropian mbetet aktor i rëndësishëm në rajon dhe donatori më i madh i Kosovës, i cili ndan më shumë mjete për kokë banori në Kosovë sesa në secilin vend të botës. Asistenca dhe angazhimi i BE-së janë një mbështetje e fuqishme për një të ardhme të sigurtë evropiane për Kosovën.

Institucionet shtetërore duhet të kenë përgjegjësinë kryesore për të siguruar zbatimin e duhur të të gjitha aspekteve të sundimit të ligjit nëse Kosova dëshiron që ndonjëherë të jetë plotësisht e aftë për të funksionuar më vete, dhe të jetë e përgatitur për anëtarësim në BE. Dita kur institucionet e Kosovës fillojnë të përmbushin përgjegjësitë e tyre dhe të ofrojnë rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të jetë një shenjë e pjekurisë së shtetit dhe shoqërisë në përgjithësi.

## CONCLUSION

In this paper was analysed the role of the EU mission in Kosovo, EULEX, in the area of rule of law in supporting Kosovo's local institutions, as well as it has been analyzed its impact on Kosovo's approximation to the EU. This research by using analytical, interviewing, comparative and descriptive / historical methods presented Kosovo's path towards consolidating its own subjectivity as an independent and sovereign state and its western orientation and by highlighting the EU assistance through its mechanisms in Kosovo in strengthening the rule of law.

The European Union has become a key factor of political and economic stability for both Kosovo and the whole Western Balkans. The European Union remains one of Kosovo's main supporters both in economic development and especially in the rule of law through its EULEX mission. The European Union has in the early days called Kosovo as a *sui generis* historical and political case that does not precede other countries. The European Union since the international community's intervention in Kosovo treated Kosovo as a special case within the European integration process in the Western Balkans region region.

Since 1999, the European Union has been an integral part of international efforts to build a new future for Kosovo. Member States and its institutions, particularly the EU mission, EULEX, play an important role in the rule of law in Kosovo. The European Union was committed in providing peace, security, stability and an European perspective to Kosovo during its final status and also to the entire region on the basis of which it made the preliminary preparations to lead the international presence in Kosovo after its final status. EULEX Kosovo, based on the European Security and Defense policy (ESDP), was established to assist and advance Kosovo authorities in enhancing their judicial, police capacities and customs development.

In order to achieve the objectives of this research, an analysis of the factual state in the field and of the achieved results was done. The results from this research show that there has been progress in the institution of the rule of law. Kosovo last year made a step forward towards the EU by signing the Stabilization and Association Agreement, where EULEX has obviously played an important role in this regard. EULEX has played a very active role in the north of



Kosovo, when the functioning of local institutions has not been possible for a while. The EULEX mission supports to the EU-facilitated dialogue between Belgrade and Pristina by assisting the implementation of remaining dialogue agreements in the sphere of rule of law. Despite this, the security situation in the north of Kosovo remains fragile as a result of political tensions, although an agreement has been reached on the functioning of courts and prosecution in the north, this has not been implemented yet.

The presence of the European Union in Kosovo and in particular the EULEX mission has helped Kosovo to consolidate the rule of law, in full compliance with European standards and it is an important factor in Kosovo's path towards the European Union.

EULEX has also investigated and adjudicated "high profile" cases, where such are considered a group of people who have a major influence on public and political life or are related to larger political parties and businesses. Many of these cases would have been inconceivable to be handled by local courts. In many cases it has managed to prevent the political pressure exerted on judicial institutions and other independent institutions, challenging domestic impunity. This only happened when and where the mission personnel were present. The presence of EULEX in some of Kosovo's institutions has had a significant impact on the protection of the independence of the institutions.

All EULEX executive competences have already begun to decrease following the recent restructuring of the mission; most of the cases have been handed over to local judges and prosecutors. Successful taking and closing of these cases, monitored by the EU office, should be used as an indicator to measure the progress of locals in the broader field of rule of law. EULEX judges and prosecutors, who are involved with their executive powers, should be relocated to providing rigorous professional training on the best European practices for judges and prosecutors in Kosovo. The European Union should have more influence on its member countries in recognizing Kosovo's independence as soon as possible by all EU member states, which will witness the unification of the EU's position on Kosovo and will pave the way for Kosovo to make further steps towards EU integration.

In the context of opportunities for advancement of the current level, Kosovo needs to use this assistance provided by this mission like other countries in the region, in accepting and implementing EU recommendations to undertake the necessary reforms.

State institutions should have the primary responsibility to ensure the proper implementation of all aspects of the rule of law if Kosovo ever wants to be fully capable of functioning independently and be prepared for EU membership. The day when Kosovo institutions begin to fulfil their responsibilities by delivering concrete results in the fight against corruption and organized crime will be a sign of the maturity of the state and society in general.

## BIBLOGRAFIA

- Agjencioni Evropian i Rindërtimit (AER), 2008.
- Agjenda Evropiane e Qeverisë së Kosovës, Janar-dhjetor 2006
- Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it, 01 Prill 2011.
- Christopher Bennett, *Yugoslavia's Bloody Collaps*, London, 1995
- Communication from the Commission, *A European Future for Kosovo*, Brussels 20th of April 2005
  - Council Decision, *on the establishment of European Partnerships with Kosovo* as defined under resolution 1244, Brussels, 30 of January 2006
  - Council Joint Action 2008/124/CFSP of 4 February 2008 on the European Union Rule of Law Mission in Kosovo, EULEX Kosovo, OJ 2008 L 42 Article 2
  - Council joint action, Brussels, 4<sup>th</sup> of February 2008, Article 4, Implementation of the mandate
    - Council of European Union, *Presidency Conclusions*, Brussels, 14 December 2007,
    - Deklarata e shpalljes se pavaresise se Kosoves, me 17 shkurt 2008.
    - EULEX Komponenta e Gjyqësorit 20 Mars 2011.
    - EULEX lufton korrupsionin në Kosovë: 10 Shkurt 2011.
    - EULEX Programme Strategy
    - *EULEX-i nuk do të futet në Kushtetutë,*” Telegrafi, 7 korrik 2012,
    - EULEX-Raport vjetor mbi aktivitetet gjyqësore të gjyqtarëve të EULEX-it.
    - European Council, *on establishing EU Rule of Law mission and appointing EU special representative in Kosovo*, 16 February 2008
    - European Union, *Consolidated Version of the Treaty of the European Union*, articles 14, 18, 23
    - European Union, *Council Joint Action* of 15 September 2006 as last amended and extended by Joint Action on appointing a EUSR in Kosovo, Brussels, 4th of February 2008
    - European Union, *Council Joint Action on EU Rule of Law Mission in Kosovo*, Brussels, 4 February 2008
    - Ftesa nga Presidentja Atifete Jahjaga drejtuar Catherine Ashton HREU, 4 shtator 2012.

○ Intervistë me Zv.shefin e Misionit të Bashkimit Evropian (EULEX) Prishtinë më 2 Shkurt 2012

○ Kërkohet futja e EULEX-it në Kushtetutë,” KohaNet, 4 korrik 2012,

○ Këshilli i Bashkimit Evropian i mbajtur më në vitin 2000 në Feira dhe e rikonfirmuar në Këshillin e Bashkimit Evropian më 24 Nëntor në Zagreb.

○ Këshilli i Veprimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian 2008/124CFSP 4 shkurt 2008 për Misionin e Sundimit të Ligjit në Kosovë, Gazeta Zyrtare L42/92, 16 shkurt 2008

○ KIPRED, intervistë me zyrtar të lartë nga Presidenca e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 7 janar 2013.

○ Komponenti Policor i EULEX-it, 03 Maj 2011

○ Kosovo(EULEX) from the Perspective of Kosovo Constitutional Law," 2010

○ Kosovo, as defined under Security Council resolution 1244: see the EC regulation No 533/2004, Brussels, 22<sup>nd</sup> of March 2004,

○ Kuvendi i Rep. së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-148, Prishtinë, 7 shtator 2012.

○ Ligji Nr. 03/L-053, Ligji mbi kompetencat

○ Marrëveshja e Tregtisë së Lirë për Evropën Qendrore/Central Europe Free Trade Agreement (CEFTA).

○ Mekanizmi Përcjellës për Stabilizim Asocim (MPSA)për rastin e Kosovës më 06 Nëntor 2002.

○ Përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian 16 Qershor 2003 mbi Agjendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor: Ecja drejt integritetit Evropian si dhe vendimet e takimit të Këshillit të Bashkimit Evropian më 19-20 Qershor 2003 në Selanik.

○ Propozimi gjithëpërfshirës për vendosjen e statusit të Kosovës i ish Presidentit Finlandez Marti Ahtisari 26 Mars 2007.

○ Renzo Daviddi, Kryesues i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, *Intervistë*, Prishtinë më 28 Shtator 2007

○ Resolution 1244, UN Security Council, 10th of June 1999

○ Rezoluta 1244 e OKB-se

○ Robert Muharremi, "The European Union Rule of Law Mission in

○ Shenoll Muharremi, drejtor i Agjencisë për Integritet Evropian(AIE), *Intervistë*, Prishtinë më 25 Tetor 2007

- Vedran Džihic dhe Helmut Kramer: Kosova pas pavarësisë. A është duke i përmbushur premtimet e saj misioni i EULEX-it?
- Vendim i Këshillit për miratimin e para të Partneriteteve Evropiane: Vendimi i Këshillit Nr. 520/2004, Bruksel, 14 Qershor 2004
- Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP, 4 shkurt 2008
- Versioni i Konsoliduar i Traktatit mbi BE-në dhe TFEU, Titulli V
- Zyra e AKM-së për privatizim e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, 13 Qershor 2002.

*Burime nga Interneti:*

[http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/dat/12002M/pdf/12002M\\_EN.pdf](http://eur-lex.europa.eu/en/treaties/dat/12002M/pdf/12002M_EN.pdf)

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2010:083:FULL:EN:PDF>

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:086:0001:0002:EN:PDF>

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:035:0032:0056:EN:PDF>

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:042:0092:0098:EN:PD>

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:042:0088:0091:EN:PDF>

<http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:042:0088:0091:EN:PDF>

<http://library.fes.de/pdf-files/id/ipa/06571.pdf>

<http://www.assemblykosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%2004-L-148.pdf>

[http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms\\_Data/docs/pressData/en/ec/97669.pdf](http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/en/ec/97669.pdf)

[http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms\\_Data/docs/pressData/en/gena/98768.pdf](http://www.consilium.europa.eu/ueDocs/cms_Data/docs/pressData/en/gena/98768.pdf)

<http://www.euinkosovo.org/uk/about/about.php>

<http://www.euinkosovo.org/upload/Commission%20Communication%20-%20European%20Future%20for%20Kosovo.pdf>

<http://www.euinkosovo.org/upload/Commission%20Communication%20%20European%20Future%20for%20Kosovo.pdf>

<http://www.euinkosovo.org/upload/Commission%20Communication%20%20European%20Future%20for%20Kosovo.pdf>

<http://www.eulex-kosovo.eu>

<http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,2>

<http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,2>

<http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,3>

<http://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,3>  
<http://www.mei-ks.net/?page=1,180>  
<http://www.eulex-kosovo.eu/en/justice/>  
<http://www.eulexkosovo.eu/en/justice/assembly-of-the-eulex-judges.php>  
<http://www.eulex-kosovo.eu/en/police/>  
[http://www.europarl.europa.eu/summits/pdf/the\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/summits/pdf/the_en.pdf)  
<http://www.koha.net/?page=1,13,10582>  
<http://www.mei-ks.net/sq/procesi-i-stabilizim-asociimit>  
<http://www.osce.org/kosovo/>  
<http://www.pak-ks.org/?page=1,5>  
[http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/blogrevieë/2010/05/21/blog-02\)](http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/blogrevieë/2010/05/21/blog-02)  
<http://www.telegrafi.com/lajme/eulex-i-nukdo-te-futet-ne-kushtetute-2-23677.html> qasur 1  
dhjetor 2012  
<http://www.unmikonline.org/civiladm/index.html>  
<http://www.unmikonline.org/press/reports/N9917289.pdf>  
[http://www.unosek.org/docref/Comprehensive\\_proposal-english.pdf](http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf)  
[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/kosovo\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/kosovo_en)  
[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/former-yugoslav-republic-of-macedonia\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/former-yugoslav-republic-of-macedonia_en)  
[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/montenegro\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/montenegro_en)  
[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/bosnia-herzegovina\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/bosnia-herzegovina_en)  
[https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/serbia\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/serbia_en)  
<https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo>